

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7435 E premte 9 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Gazeta gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung" nën titullin "Ballkani Perëndimor merr miliarda nga BE" nënvizon se strategjia e re për Ballkanin ...
Vijon në faqen 21

Nga "DEUTSCHE WELLE"

Dështim i paparë i BE në Kosovë e Bosnjë



Debati Ditës

Një vit pas ndarjes nga jeta të shkrimtarit Dritëro Agolli, familja e tij ka organizuar një takim për kujtimor. Takimi ka nxitur reagime për shkak ...
Vijon në faqen 17

Nga ELONA AGOLLI

Përkujtimorja, kritikët smirëzinj



Batutat në Kuvend nga plëndësat te prasi e karota e Divjakës

PD nuk i voton, KLGJ e KLP kalojnë automatikisht, Lu: Politikanët kanë frikë nga reforma në drejtësi

Rrëzohet rezoluta për "Jerusalem". Vota kundër SHBA, Kryemadhi: Rama i kushtëzuar nga tutorët e tij

Nga VALENTINA MADANI
Opozita refuzoi të votojë dje në Kuvend emrat për anëtarë të KLP dhe KLGJ. 72 vota pro ishin të mjaftueshme për t'i miratuar, por në bazë të Kushtetutës, ajo kaloi automatikisht me raundin e tretë. Ky ishte raundi i tretë dhe i fundit për përzgjedhjen e anëtarëve jogjyqtarë ...
Në faqet 4-5

AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE: PERFITUESIT KANE 6 MUJAJ KOHE PER DOKUMENTET

VENDIMET E 1997, 1500 PRONARET QE KOMPENSOHEN

ATP përfundon procesin e vlerësimit financiar për qytetarët që janë shpronësuar në vitin 1945 dhe kanë pranuar vendimin për t'u shpërblyer



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

INTERVISTA

Ilir Meta reagon ndaj Pavlopulos: Të ruajmë qetësinë. S'ka sintoni me Bushatin e Kotzias

Në faqen 6

VIZITAT NE SHTEPI

Nexhmije Hoxha mbush 97 vjeç, dalin fotot e para "pas vdekjes". Si duket e veja e Enverit

Në faqen 7

REKOMANDIMET

FMN kundër qeverisë: Mos i jepni rrugët me koncesion, si duhet t'i gjeni burimet

Në faqen 11

INTERVISTAT

150 minatorë protestë para parlamentit: Duam statusin, pensionet gesharake nuk mjaftojnë

Në faqen 10

NE AKSION DHE FNSH E RENEJA



Shpërthimi me tritol në Shkodër, në pranga 2 atentatorët e Lulzim Kullës, si u arrestuan Çopja e Lulaj

Në faqen 3

Zhvendosja e Teatrit, flasin Ndrenika, Kabashi, Malkaj, Fuga, Derhemi, Basha...

Përsëritet skenari i '99, artistët: S'jemi skllevër

"Hidhemi në grevë për Teatrin Kombëtar e kundër ligjit të Kumbaros"

Nga FATMIRA NIKOLLI
Tiranë, 1999. Edi Rama është ministër Kulture. Në Tiranë zien ideja se Teatri Kombëtar do shembet, në truallin e tij një firmë ndërtimi do të bëjë një pallat, 2 katet e para të të cilit do të jenë teatër. Ar-



tistët kundërshtojnë. Janë Violeta Manushi, Robert Ndrenika, Agim Qirjaqi e të tjerë në radhë të parë. Të gjithë njëzëri: JO! Para kësaj, si rrugë motivimi ishte bërë një ligj, një ligj të cilin artistët e cilësonin të mbrapshtë...
Në faqet 18-19

Arrestohet dhe 24-vjeçari Serxho Teta. Policia: Pengoi zbulimin e së vërtetës

Senad Nikshiqi

SHKODËR/ELBASAN

Afro një muaj pas atentatit me tritol në lagjen "Rus" të Shkodrës ku mbeti i plagosur 42-vjeçari Lulzim Kulla si dhe 7 personave të tjerë, policia e Shkodrës në bashkëpunim me prokurorinë e këtij rrethi kanë mundur të zbardhin dhe të dokumentojnë ngjarjen e rëndë. Në orët e para të mëngjesit të djeshëm është bërë arrestimi i dy personave që dyshohen të jenë autorë të atentatit të ndodhur më 13 janar të këtij viti. Bëhet fjalë për 29-vjeçarin Endri Çopja dhe 31-vjeçar Argel Lulajn, të dy banues në Elbasan. Dy të rinjtë u kapën gjatë operacionit të koduar "Together", në të cilin morën pjesë policia e Shkodrës forcat e RENEA-s, FNSH-së së Tiranës si dhe Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit. Gjithashtu, gjatë këtij operacioni u arrestua në flagrancë dhe 24-vjeçari Serxho Teta, banues në Elbasan, i cili akuzohet për veprën penale "Veprimi qe? pengojnë? zbulimin e se? vërtetës".


Nërkohë, dy ditë më parë policia e Elbasanit shkatërroi një tjetër grup kriminal, i cili merrej me tregtimin e minave dhe të tritolit. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se dyshohet që 6 anëtarët e këtij grupi i kanë shitur tritol bandës që kryen shpërthimin me eksploziv në Shkodër. Goditja e dy grupeve erdhi pas vizitave të kryeprokurores Arta Marku në prokurorinë e Shkodrës dhe atë të Elbasanit. Në takimet me vartësit, Prokurorja e Përgjithshme kërkoi hetimin e themel të grupeve kriminale, tashmë të sofistikuara.

ARRESTIMI I ATENTATORËVE

Pas vënies në pranga të atentatorëve të të "fortit" të Shkodrës, Lul Kulla, kreu i policisë së Shkodrës Gjovalin Loka dha detaje në lidhje me operacionin. Sipas Lokës, 29-vjeçari Endri Çopja dhe Argel Lulaj u kapën, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" në mungesë, për veprat penale: "Vrasje ne? rrethana te? tjera cile?suese mbetur në tentativë" kryer në bashkëpunim; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyes dhe i municionit", "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", të kryera në bashkëpunim. "Arrestimi i tyre u bë, pasi gjatë hetimeve të ndjekura me metoda speciale dyshohet se janë autorë për ngjarjen

Shpërthimi me tritol në Shkodër, në pranga 2 atentatorët e Lulzim Kullës

Operacioni, si u arrestuan elbasanasit Endri Çopja e Argel Lulaj nga policia, FNSH dhe RENEA



Biznesmeni i plagosur në atentat, Lulzim Kulla



Shkodër - Operacioni "Together", arrestohen autorët e dyshuar të vendosjes së eksplozivit

DYSHIMI

Dy ditë më parë, policia e Elbasanit shkatërroi një tjetër grup kriminal, i cili merrej me tregtimin e minave dhe të tritolit. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se dyshohet 6 anëtarët e këtij grupi i kanë shitur tritol bandës që kreu shpërthimin me eksploziv në Shkodër.

OPERACIONI "TOGETHER"

TË ARRESTUAR

1. Endri Çopja, 29 vjeç, banues në Elbasan
2. Argel Lulaj, 31 vjeç, banues në Elbasan
3. Serxho Teta, 24 vjeç, banues në Elbasan

ATENTATI ME 8 TË PLAGOSUR

Paraditen e 18 janarit të këtij viti, një shpërthim i fuqishëm me tritol në lagjen "Rus" (përballë tregut të njohur si "50 lekëshi") të Shkodrës shkaktoi plagosjen e 8 personave, ku 3 prej tyre në gjendje të rëndë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije pas ngjarjes se një sasi prej 400 gr eksploziv ishte vendosur në një motor të parkuar pranë një objekti 2-katësh në pronësi të të "fortit" të Shkodrës, Lulzim Kulla dhe është shpërthyer me telekomandë në momentin kur shënjestra po largohej me makinën e tij tip "Fuoristradë".

e ndodhur më 13 janar të vitit 2018 ku mbetën të plagosur me lëndë plasëse 8 shtetas, ndër ta edhe shtetasi me iniciale L.K., i cili dy-

shohet se ishte objektiv i atentatit. Gjithashtu, u arrestua në flagrancë shtetasi Serxho Teta për veprën penale "Veprime qe? pengojnë zbulimin e se? vërtetës".

"Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyes dhe i municionit", tha Loka.

Ndërkaq, mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në banesat e të arrestuarve, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materi-

ale disa celularë, 4 automjete, 2 nga të cilat janë përdorur nga autorët ditën e ngjarjes, 6 000 euro, tre maska dhe fishekë luftarake.

"Porosia", sekuestrohen 82 kallëpe eksploziv, armë e drogë

Shkatërrohet banda e tritolit, arrestohen 5 persona nga Pogradeci dhe Gramshi

ELBASAN - Policia e Shtetit ka goditur një grup të strukturuar kriminal duke arrestuar 5 persona dhe shpallur në kërkim një tjetër. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Porosia", i cili u zhvillua të mërkurën në Elbasan u sekuestruan 82 kallëpe tritol, drogë, armë, celularë dhe një sasi të konsiderueshme parash. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se pas një hetimi një muaj me metoda speciale (agjentë të infiltruar) u bë e mundur vënja në pranga e shtetasve: Geraldo Yzeirllari, 20 vjeç, banues në Pogradec; Kristi Maxhari, 21 vjeç, banues në Pogradec; Kristian Petani, 22 vjeç, banues në Pogradec; Kristian Petani, 22 vjeç, ban-



Personat e shoqëruar dhe të arrestuar gjatë operacionit "Porosia"

ues në Pogradec; Edmond Abazi, 39 vjeç, banues në fshatin Hudenisht, Pogradec dhe Gazmor Kokla, 39 vjeç, banues në fshatin Gribë,

Gramsh. Arrestimi i tyre u krye nga forcat e posaçme në disa ndërhyrje në Pogradec dhe në Gramsh. Burimet e mësipërme pohuan se sh-

OPERACIONI "POROSIA"

TË ARRESTUAR

1. Geraldo Yzeirllari, 20 vjeç, banues në Pogradec;
2. Kristi Maxhari, 21 vjeç, banues në Pogradec;
3. Kristian Petani, 22 vjeç, banues në Pogradec;
4. Edmond Abazi, 39 vjeç, banues në fshatin Hudenisht, Pogradec;
5. Gazmor Kokla, 39 vjeç, banues në fshatin Gribë, Gramsh.

NË KËRKIM

E.H., 20 vjeç, banues në Pogradec

tetasve Geraldo Yzeirllari dhe Kristi Maxhari u janë gjetur dhe sekuestruar 82 kallëpe të llojit tritol. Ndërsa, Edmond Abazit i është gjetur dhe sekuestruar 1.5 kg kanabis. Gjatë kontrollit të banesës së Gazmor Koklas në Gramsh janë gjetur 1 automatik; 1 pushkë me 440 fishekë, 3 automjete, 15 celularë si dhe sasi e konsiderueshme lekësh. Gjithashtu, në kuadër të këtij procedimi penal është shpallur

në kërkim shtetasi E.H., 20 vjeç banues në Pogradec, i dyshuar për veprat penale: "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Ndërkaq, vijnë hetimet për dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të këtyre shtetasve, si dhe identifikimin e bashkëpunëtorëve të tjerë të mundshëm.

KUVENDI DEBATET

EDI PALOKA

Deputeti i PD, Edi Paloka, denoncoi dje mënyrën e të shprehurit të kryeministrit Rama në Kuvend, ku ka përdorur termin "çifut" për hebrejtë. "Emërtimi 'çifut' është një term që përdoret dhe përdoret me përbuzje dhe urrejtje nga antisemitët. Për raste kur ky term u ka shpëtuar pa dashje, figura të ndryshme politike në botë janë detyruar të japin dorëheqjen. Kryeministri shqiptar e përdori me vetëdije të plotë në një seancë ku flitej pikërisht për SHBA-të dhe Izraelin".



FALENDERIMI

FATMIR XHAFAJ

"Vlerësimet më të mira për drejtuesit & oficerët e Policisë Kriminale të Drejtorisë Shkodër, që në pak javë zhvilluan 2 operacione të shkëlqyera. Përgëzime për angazhimin profesional Forcave Operacionale & RENEA. Falënderim i sinqertë për frymën bashkëpunuese prokurorisë së këtij qyteti", shprehet z.Xhafaj.



REAGIMI

AGRON DUKA

Kreu i PAA-së, Agron Duka reagoi dje ndaj seancës plenare, duke theksuar se të rinjtë janë shndërruar në ambasadorë të mjerimit. "Vërimin gishtin kokës, sepse batutat e vjedhura nga kinostudio 'Shqipëria e Re' nuk fshehin dot vjedhjen e shpresës, që po u bëni përditë të rinjve dhe të rejaeve të këtij vendi", tha Duka.

Kuvendi rrëzon me votat e PS-PDIU rezolutën e opozitës për Jerusalem

PD nuk voton 10 emrat, KLGJ dhe KLP kalojnë automatikisht

Lu: Politikanët kanë frikë nga reforma në drejtësi

Valentina Madani

Opozita refuzoi të votojë dje në Kuvend emrat për anëtarë të KLP dhe KLGJ. 72 vota pro ishin të mjaftueshme për t'i miratuar, por në bazë të Kushtetutës, ajo kaloi automatikisht me raundin e tretë. Ky ishte raundi i tretë dhe i fundit për përzgjedhjen e anëtarëve joqytarë dhe jo-prokurorë për në KLP dhe KLGJ. Opozita kundërshtoi listën e kandidatëve për të dy këshillat, duke sjellë në vëmendje qëndrimet e mbajtura për secilin prej tyre nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Kur asnjë prej kandidatëve nuk arriti të merrte katër vota nga anëtarët e nënkomisionit Ad-Hoc, goglat përzgjedhën edhe listat e kandidatëve, që i janë përcjellë Kuvendit dhe u miratuan këtë të enjte në seancë. Ky ishte votimi i tretë që parlamenti bëri për anëtarët e KLP-së dhe KLGJ-së, pasi dy raundet e para dështuan, sepse ishin të nevojshme 94 vota. Por, imenjëherëshëm ishte reagimi i ambasadorit amerikan, Donald Lu, përmes një mesazhi të fortë pas ngritjes së KLGJ dhe KLP në Kuvend. Sipas tij, politikanët e majtë dhe të djathtë kanë frikë nga reforma në drejtësi. "Mos u përqendroni në lajmin e keq se politikanet dështuan sërish të bashkëpunojnë në përzgjedhjen e anëtarëve të KLGJ dhe KLP. Përqendrohuni në lajmin e mirë se Kushtetuta e kishte parashikuar këtë gjë dhe sot i përzgjedhi anëtarët në mënyrë rastësore. Unë kam më shumë besim në një përzgjedhje të rastit sesa në përzgjedhjen nga politika-



Vota kundër SHBA, Kryemadhi: Rama, i kushtëzuar nga tutorët e tij

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, foli dje në parlament për votën e Shqipërisë kundër SHBA-ve në OKB. Kryemadhi tha se vota e 21 dhjetorit ishte faqja më e errët në historinë e politikës së jashtme. Kryetarja e LSI-së tha se Rama votoi i kushtëzuar nga tutorët e tij dhe nuk veprroi në interes kombëtar. "S'duhet të ishim pjesë e votës anti-



amerikane. Reagimet e shqiptarëve e pamë se si janë për qëndrimet e çartura të Edi Ramës. Besoj se dëgjuam edhe qëndrimin e diasporës

kanët. Reforma në drejtësi ka hedhur një hap përpara", shprehet ambasadori amerikan në Tiranë. **REZOLUTA** Parlamenti rrëzoi dje me 73 vota kundër dhe 11 pro, projektrezolutën e Partisë Demokratike, që i kërkonte qeverisë shqiptare që të ndryshonte qëndrimin lidhur me qëndrimin kundër në OKB për të njohur Jerusalem si kryeqytet të Izraelit. Për këtë qëndrim u miratua rezoluta e PS-së me 73 vota pro dhe 11 kundër, e cila e mbësh-

tet qëndrimin e mbajtur nga qeveria. Kjo rezolutë u miratua edhe me vota e PDIU-së. Mazhorana edhe në debatin që është zhvilluar gjatë ditës e djeshme deklaroi se nuk do të votonte pro dhe dorëzoi një projektrezolutë paralele. Ndërkohë që në Kuvend kundër SHBA-ve që Shqipëria dhe në OKB, Partia Socialiste doli dje me një rezolutë paralele. Sipas rezolutës me të cilën PS i drejtohet Kuvendit për "Qën-

BASHKIMI EUROPIAN

"Me përfundimin e përzgjedhjes së anëtarëve joqytarë/prokurorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), reforma në drejtësi bëri një tjetër hap të rëndësishëm përpara!" thuhet në deklaratën e BE-së.




Kreu i Kuvendit e zëvendëson me Hysin

Komiteti i Stabilizim Asociomit, Pollo: Largoni Tahirin, nuk po numëroj mëkatet

Saimir Tahiri u zëvendësua dje nga Vasilika Hysi në Komitetin Kombëtar të Stabilizimit Asociomit. Punimet e komisionit nisën të hënën në Tiranë. Kërkesën për zëvendësimin e bëri Genc Pollo që në nisje të seancës, por pa ditur që Ruçi e kishte marrë këtë vendim tashmë. "Ditën e hënën fillon punimet në Tiranë Komisioni i Stabilizimit Asociomit midis Kuvendit dhe PE. Vërej që në delegacionin e Kuvendit është ende anëtar Saimir Tahiri, si përfaqësues i grupit socialist që nga vjeshta e kaluar. Është edhe fotoja e tij në faqen e Kuvendit. Nuk po numëroj mëkatet e Tahir-it. Do ju kërkoja që kompetencën tuaj si kryetar; por edhe anëtar i grupit socialist të shqyrtoni mundësinë e zëvendësimit të tij dhe të njoftimit të seancës plenare sot ose deri ditën e diel, në mënyrë që të kemi një problem më pak në mbledhjen e së hënës me eurodeputetët", u shpreh Pollo.

"Ta dënojmë me forcë sikundër Shqipëria duhet të konsiderojë dhe qëndrimin ndaj Jerusalem-it". Shqipëria nuk do të bëhet kurrë shtojcën e sigurisë në politikën e sigurisë globale", tha z.Berisha. Kurse kryeministri Rama u shpreh: "Sot kërkoni shpëtimin në Lindjen e Mesme. Sa të jetë kjo parti në qeveri, nuk kemi asnjë shans që ky vend të mbetet pa drejtësi. Jeni gati të bëheni çifutë, eskimezë, dele e zezë e të fshiheni pas një identiteti tjetër e të mos ju kapin". Po dje projektligji për statusin e minatorit, një propozim i deputetit të LSI, Përparim Spahiu LSI, u rrëzua me 70 vota kundër. 4 abstenime dhe 9 pro. Gjithashtu, në Kuvend kaloi edhe ligji për menaxhimin e burimeve ujore, me 73 vota pro dhe 10 kundër.



REZOLUTA

MAZHORANCA

PS i drejtohet Kuvendit për "Qëndrimin e Shqipërisë mbi statusin e Jerusalemit" dhe: "I kërkon qeverisë që në përputhje me interesin kombëtar, të vijojë të bashkëpunojë për forcimin e paqes, sigurisë dhe bashkëpunimin në tërë rajonin e Lindjes së Mesme, me aleatët dhe partnerët strategjikë, në radhë të parë SHBA dhe BE".



DEBATI

DITMIR BUSHATI

"Jeni e para opozitë në botë, gënjeshtarë të pashembullt. Ju po i bëni një shërbim shumë të keq jo thjesht opozitës, por vendit, imazhit të tij, duke stisur tema debati që nuk janë të tilla. Kur pashë firmat e ish-ministrave të Jashtëm thashë 'ose këta njerëz nuk e dinë çfarë kanë firmosur, ose nuk e njohin turpin'", tha Bushati.



AKUZA

PETRIT VASILI

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili, reagoi pas deklaratave të kryeministrit Rama në lidhje me votën në OKB për statusin Jerusalemit. Vasili dënoi gjuhën e përdorur nga Rama, duke e quajtur naziskin. "Sot psikologjia prej naziskini duhet të jetë një shqetësim mbarëpopullor", tha z. Vasili.



Batutat në Kuvend nga Jerusalemi, tek prasi e karota e Divjakës

Basha: Çohuni! Na keni në krah. Rama: Do të të rrahin

Kreu i PD: Bushati, mashtrues i pacipë

Valentina Madani

Opozita ndryshe nga një javë më parë, dhe nuk bllokoi foltoren e Kuvendit, por ashpërsi gjuhën ndaj mazhorancës dhe kreut të saj, Edi Rama, për lidhjet me krimin e organizuar dhe votën kundër SHBA-ve në OKB. Por, akuzat u shpërthuan jo rrallë edhe me batuta gjatë seancës së djeshme plenare nga Jerusalemi e Palestina deri tek rakia, prasi e karota e Divjakës. Kryeministri Rama tha se opozita do vetëm të fshihet e sipas tij, nisen për diku dhe kthehen për diku tjetër, nga Jerusalemi tek karota, nga Palestina tek prasi. Rama përmendi sërish "Gurin" dhe i kujtoi lapsusin me llogaritjet matematikore të bëra nga Basha në Kuvend. Kryeministri e paralajmëroi Bashën edhe se do e rrahin. "A ju thashë, duan vetëm një vend ku të fshihen. Duan vetëm t'i ikin ëndrrës së keqe që shohin me sy hapur dhe që i lë pa gjumë, prandaj nisen për diku, pastaj veçse kthehen për diku tjetër. Sot erdhën këtu, ishin nisur për Jerusalemi, befas komisar ndaloj në Divjakë. Shtatë herë shtatë 42. Nga Jerusalemi tek karota, nga Palestina tek prasi. Guri, o guri hajde se do na rrahin, hajde guri se po na rrahin. Një gjë po ta them i dashur miku im Lulzim, ma dëgjo sot këtu përpara të gjithëve, unë e di si do shkojë kjo punë, e mbaj mend. Në fund këta do të rrahin ty, se do iu ngordhë gomari dhe do i bien samarit. Pastaj 7x7 42, një kg karota, gysmë kilë presh, në fund do përfundojë kjo punë që do të nxjerrin këta në



rrugë të madhe. Pastaj si ta kesh fatin ti, edhe këta... Ka një stacion, stacioni është drejtësia e re, aty do shikojmë kush jeni ju e kush jemi ne", deklaroi Rama. Mocionin për diskutimin e votës së Shqipërisë në OKB për Jerusalemin 2 muaj më parë, kryeministri Edi Rama e quajti si një justifikim të opozitës nga frika e reformës në drejtësi.

Rama tha se demokratët janë të trembur nga vetingu dhe organet e reja të drejtësisë. "Druri i ligjit në kokën e të gjithë atyre që i kanë kusur këtë popull për t'ia kthyer. Me SHBA-të nuk ju bashkon dot Jerusalemi ju, se ju ndan drejtësia", tha z.Rama. Në kundërpërgjigje, kryetari i opozitës, Lulzim Basha u shpreh kjo reformë u shkatër-

rua si pasojë e kapjes nga Edi Rama dhe u bëri thirrje qytetarëve të marrin në dorë fatet e tyre. "Nuk ka reformë në drejtësi, por reformë për të mbrojtur Tahirin, Beqajm, Shullazët, Dakon. Të marrin fatin tonë në duart tona. Çohuni dhe opozitën do ta keni në krah. Sa herë që të bllokoni një aks, opozitën do ta keni në krah, mua do më keni në krah. Kreu i PD-së ishte i ashpër me ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati, duke e akuzuar si të paafte dhe mashtrues. "Rrallëherë do të keni shansin të shihni një mashtrues të pacipë dhe të paafte nën petkun e ministrit të Jashtëm. Kujdesen dhe janë kujdesur qeveritë që njerëzit që përfaqësojnë Shqipërinë në botë të mos jenë mashtrues kalibri, të paafte dhe plagjatë të pakorrektoeshëm", tha z.Basha.

"Erdogani lëshoi Kosovën për kurdët"

Berisha, Ramës: Shko bëhu synet në Turqi

Ish-kryeministri Sali Berisha nuk kursye dje akuzat, por edhe batutat në distancë me kryeministrin Rama. Teksa po fliste në foltoren e Kuvendit, duke thënë se nuk binte dakord me presidentin turk që thotë Kosova nuk u bë shtet, z.Rama i foli nga karrigia e tij. Kaq mjaftoi që Berisha t'i sugjeronte që të shkojë të bëhet "synet" në Turqi. "Do të them një gjë, shpreh vlerësimin e madh për Turqinë dhe presidentin e saj, por nuk pajtohem kurrë me presidentin e saj kur thotë se Kosova nuk u bë shtet. Njeriu që... Ore shko bëhu synet ti atje, unë jam Sali Berisha. Je gabim ti, shko bëhu synet atje. Unë i kam publike qëndrimet e mia, nuk mund të pajtohem kurrë me deklaratën e tij. Kur i erdhi çështja kurdë, tani duhej lëshuar Kosova", tha z.Berisha. Në replikë, kryeministri Rama pati një sugjerim për paraardhësin e tij: "Lëri bijtë të luftojnë tani, boll luftove se u lodhe dhe ke halle përpara. Ne nuk të ndihmojmë dot". Berisha deklaroi se vota në OKB ishte kundër interesit shqiptar, por Rama u përgjigj: "S'jua kemi fajin që kanë filluar t'iu thyhen arrat. Nuk e gjeni dot në Jerusalemi shpëtimin, Sali! Strehën që po ju shembet. Strehja po shembet në këtë betejë. Nuk ju bashkon Jerusalemi ju, se nuk ju bashkon drejtësia. Hajde votoni KLP e KLGJ. Ju nuk doni as KLP e as KLGJ. Nuk mund të votoni vazhdimin e një procesi që mund tua lidhë duart në fund. Keni bërë shumë e mbuluar shumë".



Alibeaj, kallëzim penal për Gjonajn: Në burgun 313 ka një qeli bosh

Interpelanca e kërkuar me iministrin e Drejtësisë, Etilda Gjonajn në lidhje me ekstradimin e Nezar Seitit, financierin e dyshuar të grupit Habilaj ka përfunduar me njoftimin e deputetit Enkelejd Alibeaj për depozitimin e një kallëzimi penal kundër ministres Gjonaj për shpërdorim detyre. Kërkesës së deputetit Alibeaj, nëse ka pasur ndonjë letër-porosi për hetime ndaj Nezar Seitit, ministrja Gjonaj i është përgjigjur se nuk ka. Por sipas Alibeajt, Prokuroria e Krimeve të Rënda e ka bërë këtë kërkesë. Ministrja Etilda



Gjonaj e quajti këtë interpelancë si sulm politik të bërë nga frika nga reforma në drejtësi. Sipas ministres, kur për një shtetas ka dy procedime penale, përparësi merr shteti që i ka më të avancuara hetimet ndaj tij. Ky qëndrim u kundërshtua nga deputeti Alibeaj, i cili

tha se sipas Kodit të Procedurës Penale, përparësi merr prokuroria shqiptare dhe Nezar Seiti nuk duhej ekstraduar: "Ministrja e Drejtësisë duhet të bënte verifikime para se të vendoste ekstradimin e Nezar Seitit. Ekstradimi Nezar Seitin me ngut, duke mos respektuar ligjin. Financieri i bandës së Habilajve ishte e vetmja gojë që do të fliste. Në historinë mes hajdutëve dhe kriminelëve, ju ku e fusni veten? Pranoni përgjegjësinë. Në burgun 313 ka një qeli e lënë bosh, e vetme ajo qeli nuk ju mban të gjithëve", tha z.Alibeaj.

RAPORTI ME GREQINË REAGIMET

Presidenti reagon ndaj presidentit grek: Të ruajmë qetësinë e respektin reciprok

Ilir Meta: Pavlopulos, jo në sintoni me Bushatin e Kotzias

"Shqipëria mund të ecë më shpejt drejt çeljes së negociatave"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, iu gjëgjgj djehomologut grek, Pavlopulos, i cili kërcënoi Shqipërinë me mosmbështetje në BE për hapjen e negociatave. Në një intervistë për "Albanian Daily News", Meta tha se qëndrimet e homologut të tij grek nuk sjellin energji pozitive. "Këto deklarata nuk janë në sintoni me mesazhet dhe angazhimet publike të kohëve të fundit të ministrave të Jashtëm Bushati dhe Kotzias për të çliruar energji të reja pozitive në marrëdhëniet mes dy vendeve, duke trajtuar me vetëpërmbytje dhe konstruktivitet pengesa të së kaluarës", tha Meta.

Zoti President, Komisioni Evropian sapo publikoi Strategjinë e Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor. Por, ndërkohë që Komisioni Evropian e konsideron këtë dokument një inkurajim të madh për një afrim më të shpejtë të rajonit në BE, konstatimet për gjendjen aktuale ku flitet për "kapjen e shtetit duke përfshirë lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe një përzierje të fortë mes intereseve publike dhe atyre private" flasin për regres në vend të progresit. Si e lexoni ju këtë raport?

Së pari, dua të vlerësoj kthjelltësinë dhe peshën me të cilën Bashkimi Evropian konsideron Ballkanin Perëndimor. Kjo strategji dhe Samiti i Sofjes dëshmojnë se rajoni qëndron ndaj çështjet prioritare e strategjike për BE-në, si në aspektin strategjik, ashtu edhe atë politik, institucional, ekonomik dhe qytetar.

Qartësia e panoramës aktuale në rajon besoj se ka çuar në drejtpeshimin e vendimit për të qenë më të vëmendshëm dhe më të angazhuar me një plan aksioni konkret për secilin vend. Kjo është një

qasje inkurajuese, përsa kohë vendet tona kanë zgjedhur t'i bashkohen Unionit për t'u bërë partnerë të barabartë dhe të denjë në aplikimin e standardeve të jetesës, të ligjeve, demokracisë dhe zhvillimit.

Sa më e afërt të bëhet kjo marrëdhënie, aq më i repretë është vlerësimi dhe aq më shumë përparon vendi. Kjo strategji mendoj se është inkurajuese dhe se krijon një ekuilibër shumë të mirë ndërmjet identifikimit të rrezeve që kanosen dhe domosdoshmërisë për të intensifikuar marrëdhëniet e BE-së



me të 6 shtetet e rajonit.

Që në shtatorin e vitit të kaluar presidenti i Komisionit Evropian, Juncker, paralajmëroi se do të ketë një favorizim të Serbisë dhe Malit të Zi në raport me vendet e tjera të Ballkanit në proceset e integritetit. Si e konsideroni ju faktin që këto dy vende kanë një kalendar konkret anëtarësimi, ndërkohë që Shqipëria nuk përfshihet në këtë paketë?

Nëpërmjet kësaj strategjie, Komisioni Evropian mendoj se ripothon dy gur-theme të procesit të integritetit. Së pari, perspektivën për anëtarësim të plotë dhe së dyti, siguron një proces të merituar individual sa i përket afimit në standardet e bashkëjetesës evropiane. Thënë kjo, entuziazmi dhe pa durimi ynë për ta përshkuar

sa më shpejt këtë rrugëtim është kreu legjitim, madje në kontekstin aktual mendoj se është një aset që meriton vlerësim. Shqipëria i ka të gjitha mundësitë të rrisë shpejtësinë e ecjes, por kjo kërkon vullnet të konsoliduar politik. BE kërkon të shikojë reforma më të thella, gjithëpërfshirëse dhe bindëse në fusha vendimtare, veçanërisht për të siguruar institucionet demokratike funksionale dhe sundimin e ligjit. Sikundër citon raportin: "...ensuring constructive dialogue across the political spectrum, notably within the parliaments..."

rivendosja e dialogut politik merr përparësi të veçantë. Si President i Republikës do të bëja thirrje për një lexim të kujdesshëm, të vëmendshëm dhe racional të strategjisë nga të gjithë aktorët politikë dhe institucionalë për prioritetizimin e aksioneve që duhen ndërmarrë për të realizuar çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit në BE. Po kështu, theksoj rëndësinë që ka ruajtja e koherencës mes deklaratave angazhuese dhe planeve vepruese, për të siguruar seriozitetin dhe besueshmërinë e zbatimit të reformave. Besueshmëria ishte edhe fjala kyçe e strategjisë së re të zgjerimit, e domosdoshme për t'u arritur si në raport me qytetarët, ashtu edhe me partnerët tanë institucionalë.

Autoritetet e Kosovës kanë pasur reagime të përbajtura, madje edhe skeptike për strategjinë. Ata vërejnë se Kosova vlerësohet në mënyrë asimetrike dhe se kjo strategji nuk ofron një perspektivë të qartë evropiane për Kosovën. Si e shpjegojnë këtë kontrast mes en-

tuziazmit të Tiranës dhe pakënaqësisë së Prishtinës?

Fillimisht, dua të vë në dukje se në këtë 10-vjetor të pavarësisë, Kosova ka shumëçka për t'u krenuar. Përparimi i Kosovës në të gjitha fushat është evident, përfshirë edhe në proceset e saj integruuese evropiane dhe euroatlantike. Autoritetet qeverisëse në Kosovë dhe të gjithë qytetarët e saj e kanë bërë zgjedhjen e tyre të mençur për të ecur në këtë rrugë dhe kjo është shumë e rëndësishme, madje do të thosha kyçe për t'i bërë këto procese të pakthyeshme. Mendoj se vëllezërit tanë kosovarë duhet që me durim, maturi dhe përgjegjshmëri të vazhdojnë zbatimin e agjendës së reformave evropiane, duke u dhënë përparësi çështjeve kyçe që lidhen me liberalizimin sa më parë të vizave dhe të zbatimit të MSA-së. Unë besoj në kurajën dhe aftësitë e drejtuesve të Kosovës për t'i mundësuar këto zhvillime, ashtu sikundër besoj në vullnetin e mirë që gjendet në Bashkimin Evropian për realizuar angazhimet e premtura sapo të arrihet përparimi.

Po marrëdhëniet dipalëshe me Greqinë sa do të mund të rrezikojn çeljen e negociatave për Shqipërinë, kur Presidenti i Greqisë, Pavlopulos, pak ditë më parë kërcënoi dhe kushtëzoi këtë proces me probleme të veçanta të marrëdhënieve dipalëshe?

Dua të nënvizoj se këto deklarata nuk janë në sintoni me mesazhet dhe angazhimet publike të kohëve të fundit të ministrave të Jashtëm, Bushati dhe Kotzias për të çliruar energji të reja pozitive në marrëdhëniet mes dy vendeve, duke trajtuar me vetëpërmbytje dhe konstruktivitet pengesa të së kaluarës. Spektri i bashkëpunimit midis dy vendeve është i gjithan-



Presidenti grek harron se Shqipëria është në NATO

Pavlopulos: Autoritetet shqiptare gabojnë, po mbështesin bashkëpunëtorët e nazistëve

Presidenti grek deklaroi se Athina dëshironte perspektivën evropiane të Shqipërisë dhe përfshirjen në NATO, por ajo duhet të respektojë të drejtat e minoritetit, që janë të domosdoshme, sipas agjencisë greke të lajmeve "ANA-MPA". "Autoritetet shqiptare po bëjnë një gabim të madh, duke mbështetur të drejtat e pretenduara të disa shqiptarëve që bashkëpunuan me nazistët gjatë pushtimit gjerman të Greqisë", deklaroi Pavlopulos, duke shtuar se ata që po presin t'i bashkohen NATO-s dhe BE-së nuk duhet të mbështesin të drejtat inekzistente të bashkëpunëtorëve të nazistëve. "Kur të ndryshojnë qëndrimin, Greqia do të jetë po këtu për të mbështetur vendin e saj fqinj për anëtarësimin në NATO dhe BE", përfundoi Pavlopulos, duke harruar kështu që Shqipëria është anëtare e NATO-s prej 9 vitesh. Këto deklarata presidenti grek, Prokopios Pavlopulos, i bëri gjatë takimit të djeshëm me homologun e tij georgjيان, Georgy Margvelashvili, në Athinë. Ai përmendi në këtë takim edhe problemet e vendit të tij me Turqinë dhe Maqedoninë.

shëm dhe me rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për vendet tona, por mbi të gjitha për popujt dhe njerëzit tanë. Natyrisht, mund të ketë edhe çështje të caktuara për të cilat mund të ndajmë qëndrime të ndryshme, por kjo nuk do të thotë të humbasim qetësinë në komunikimin me njëri-tjetrin dhe as për këtë arsye të cenojmë bashkëpunimin e gjithanshëm dhe jetik për të dyja vendet dhe popujt tanë. Partneriteti nuk është thjesht një koncept dhe një dokument, por në radhë të një qëndrime të ndryshme, por kjo nuk do të thotë të humbasim qetësinë në komunikimin me njëri-tjetrin dhe as për këtë arsye të cenojmë bashkëpunimin e gjithanshëm dhe jetik për të dyja vendet dhe popujt tanë. Partneriteti nuk është thjesht një koncept dhe një dokument, por në radhë të një qëndrime të ndryshme, por kjo nuk do të thotë të humbasim qetësinë në komunikimin me njëri-tjetrin dhe as për këtë arsye të cenojmë bashkëpunimin e gjithanshëm dhe jetik për të dyja vendet dhe popujt tanë.

Përmbasuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurine :

"Toko Are truall nr pasurine 222/11, vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush, Njesia Administrative Berdisa, bashkia Shkoder

2. Cmimi me te cilin do te filloje shitja ne ankand per pasurine e siperepshkruar, eshte ne vleren 463.680 (katerqind e gjashtedjete e tremje e gjashteqind e tetedjete) leke

Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 15.02.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbasuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Parcallo Gjyqësor se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6

NJOFTIM ANKANDI

Përmbasues gjyqësor privat Artan Sima, në datë 26/02/2018, ditën e Hënë, ora 16,00, përfundon ankandin e fi (të parë), për shitjen e pasurisë së paligjshme të lojit "Apartament" me sipërfaqe 34,6m², e ndodhur në Bllisht, Bashkia Devoll në vlerën 1.840.000 lekë. Pasuria është lenë garanci nga debitorët z.Genci Sami Berberi banues në Bllisht, Bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fatmir Ymer Kutrolli.

Ankandi zhvillohet pranë zyrës së përmbasuesit me seli lajgen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 .k.1. Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e debitorit Shogeria "Extra Cleaner" sh.p.k dhe Hipotekuese A Milla. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :

- "Apartament" me numur pasurie 1/126+1 - 4 Zone Kadastrale 8170 Volumi 1, Faqe 154, me sipërfaqe 75.1 m², në adresën Rr "Q Stafa" pall 8, shk 1, kati dyte . Ap 4 Tiranë

Ankandi i pasurisë fillon me cmimin fillestar në masën 42.056 Euro

Ankandi do të zhvillohet në datë 21.02.2018 në orën 15:00 në sallin e shoqërisë Buv "Gjergj Fishta" Pall i shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit duhet te paraqiten ose te kontaktojnë tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir.dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com



Kreu i grupit të PS-së: Prokuroria të hetojë

Taulant Balla: Sali Berisha, në hetim nga SHBA-të për "Rapiscan"

Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroj dje se ish-kryeministri Sali Berisha është në hetim në SHBA për aferën e "Rapiscanit". "Në SHBA është duke u hetuar sot çështja e 'Rapiscanit', biznesi që mban firmën e Sali Berishës dhe që sot shkatërron xhepat e qytetarëve shqiptarë, por edhe të qytetarëve amerikanë. Ne duhet të hetojmë, këtu i bëj thirrje prokurorisë, e të ndëshkojmë një biznes që deklarohet 250 milionë euro në bursë; shitet gjysma e tij për 4.5 dollarë, e pastaj kjo gjysmë shkon e hipotekohet në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri dhe për kolateral merr 2 milionë euro", u shpreh deputeti i PS-së. "Si mund të shitet gjysma e një biznesi 250 milionë euro për 4.5 dollarë, e më pas të shkojë në bankë, të regjistrohet për kolateral dhe të marrë kredi 2 milionë euro? Pra, është shumë e qartë që Sali Berisha ka hyrë në pazar për një biznes, i cili ka dëmtuar ata që investojnë në bursat amerikane. Sot ky është një hetim në SHBA", u shpreh Balla. Reagimin e tij, Balla e bëri gjatë fjalës që mbajti për qëndrimin e qeverisë për rezolutën për statusin e Jerusalemit. Duke iu drejtuar kreut të PD-së, Balla tha: "Lulzim, si në asnjë rast tjetër në historinë e Shqipërisë, sot interesat e shqiptarëve dhe interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përputhen me një qëllim të vetëm, që në këtë vend të vendoset drejtësia dhe shteti ligjor, i cili është garancia e vetme që ne në këtë vend të bëjmë drejtësi dhe të jemi një partner serioz i Shteteve të Bashkuara të Amerikës".



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DIHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORES LITUM" (ECLITI) SH.P.K

Shoqëria Përmbarimore "Executores Litum" sh.p.k do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e paluajtshme :

Njësi me nr. Pasurie 6/121-N12, vol 22, fq.28, e regjistruar në ZVRPP Tiranë ZK 8160, me sipërfaqe 37 m2, në pronësi të Albert Sokol Elezi
Çmimi me të cilin do të fillon ankandi është në vlerën 20.720 Euro
Ankandi do të zhvillohet në datë 05.03.2018 ora 16:00, në zyrën përmbarimore "Executores Litum" sh.p.k, me adresë Biv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tiranë.

Ministri i Shtetit në krah të Ivica Daçiç, në Mëngjesin e Lutjeve në Uashington

Senatori i Miçiganit: Shumë të rinj shqiptarë rrezikojnë deportimin nga SHBA

Majko: Po punojmë për koordinim më të mirë të shqiptarëve

Darina Tanushi

Të rinjtë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rrezikojnë deportimin nga mosarritja e një marrëveshjeje me programin që mbrohet emigrantët në vend. Kjo i është thënë ministrit të Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, nga senatori i shtetit të Miçiganit, njëkohësisht kryetar i Grupit për Çështjet Shqiptare në Senat, z. Gary Peters. Pasi e falënderoi senatorin Peters për punën e tij në mbështetje të komunitetit shqiptar në Miçigan, ministri Majko e informoi atë mbi përplekjet që po bëhen në bashkëpunim me qeverinë shqiptare për të forcur marrëdhëniet me diasporën shqiptare kudo në botë. Majko u ndal tek rëndësia që qeveria i kushton komunitetit shqiptar në SHBA, si një prej komuniteteve më të mëdha. "Po punojmë për të mundësuar një koordinim më të mirë të shqiptarëve jashtë vendit, jo vetëm për një përfaqësim më të madh të tyre në vendin pritës, por edhe për krijimin e lidhjeve më të forta mes anëtarëve të komunitetit", u shpreh ministri, sipas të cilit kjo do të mundësojë ruajtjen e identitetit kombëtar. Ministri i Shtetit, Majko foli lidhur me planet për organizimin e një konvente të diasporës shqiptare në SHBA. U përmendën gjithashtu iniciativat që do të mundësojnë ardhjen në Shqipëri të të rinjve me origjinë shqiptare gjatë periudhës së verës.

Nga ana e tij, Senatori Peters u shpreh se pjesëtarët e komunitetit shqiptar në Miçigan janë pasuri për shtetin që ai përfaqëson. Ai bëri të ditur se do të vizitojë Shqipërinë së shpejti. Senatori iu referua rastit të disa të rinjve shqiptarë, të cilët pavarësisht shkollimit e kualifikimit profesional, rrezikojnë deportimin nga mosarritja e një marrëveshjeje për DACA-n, programi që mbrohet mijëra emigrantë në vend. Në fund, senatori Peters i shprehu mirënjohjen e tij z. Majko për rolin e Shqipërisë në strehimin e MEK-ëve, duke nënvizuar se ky gjest tregon



Pandeli Majko me Ivica Daçiç në Mëngjesin e Lutjeve në Uashington

se Shqipëria është një mike e vërtetë e SHBA-ve. Ndërkohë, ministri i Shtetit për Diasporën, i cili gjendet në një vizitë disaditore në SHBA, mori pjesë në prirjen e organizuar nga Ambasada e Kosovës në Uashington, me rastin e përvjetorit të pavarësisë. Mes të ftuarve në aktiv-

itet ishte Këshilltari për Sigurinë Kombëtare, z. Herbert Raymond McMaster, me të cilin ministri Majko zhvilloi një takim. Ndërkaq, të enjten Pandeli Majko ishte i ftuar në aktivitetin e përvitshëm të Mëngjesit të Lutjeve në Uashington, i organizuar nga Kongresi i

PRESIDENTI I KE
Presidenti i Komisionit Europian, Jean-Claude Juncker, do të fillojë turin e tij të parashikuar në vendet e Ballkanit, duke filluar nga 25 shkurti në Shkup - njoftoi dje zëvendëskryeministri maqedonas, i ngarkuar për Çështjet Europiane, Bujar Osmani. Juncker do të vizitojë edhe Serbinë, Malin e Zi, Kosovën, Bosnjë-Hercegovinën dhe Shqipërinë.

SHBA. I pranishëm në aktivitet ishte edhe Presidenti amerikan, z. Donald Trump. Mbi bazë të protokollit, ministri i Shtetit për Diasporën qëndroi krah ministrit të Jashtëm të Serbisë, z. Ivica Daçiç. Në të njëjtën tryeze gjendeshin edhe kongresmenit Robert Aderholt dhe zyrtare të tjerë të lartë.

NEXHMIJE HOXHA 97 VJEÇ, FOTO E PARË "PAS VDEKJES"

Nexhmije Hoxha, e veja e diktatorit Enver Hoxha mbushi dje 97 vjeç dhe me këtë rast ka pritur e përçjellë miq që i uruan ditëlindjen në shtëpinë e saj në Laprakë. Kjo është foto e parë pas lajmit të funddhjetorit 2017 kur mediat nxorën lajmin për vdekjen e saj. Ndërkaq Nexhmije Hoxha duket mirë nga pamja për moshën gati njëshekullore që ka. Në këtë foto ajo është bashkë me kryetarin i Partisë së Punës Muharrem Xhafa.



FOTOLAJM

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- Apartament nr.3 me sip. 90.5 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-3, Vol.18, Fq.80, e ndodhur në Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **79.640 Euro**.
- 2- Apartament nr.4 me sip. 103.4 m², ZVRPP Tiranë, ZK: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-4, Vol.18, Fq.81, e ndodhur në Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **90.992 Euro**.
- 3- Apartament nr.16 me sip. 189 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-16, Vol.18, Fq.93, e ndodhur në Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **166.320 Euro**.
- 4- Apartament nr.20 me sip. 103.5 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-20, e ndodhur në Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **91.080 Euro**.

Ankandi për të gjitha pasuritë e sipërcituarat zhvillohet në datë 22.02.2018, ora 16.00 në zyrën e shoqërisë "EPSA" shpk te ndodhur në Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tiranë.

Për cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

Rikthehet çështja për hetim, fletë-thirrja e parë i shkoi Shkëlzen Berishës

Skandali "CEZ-DIA", Genc Ruli: Sqarova bazuar në prova reale

Ish-ministri Ruli dëshmon në prokurori

Ish-ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjie të Këmbës, Genc Ruli ka dëshmuar në prokurorinë e Tiranës për çështjen CEZ. Bëhet me dije se ish-ministri demokrat, ka dëshmuar përpara grupit hetimor mbrëmjen e së mërkurës. Mësohet se Ruli ka qëndruar rreth një orë në prokurori duke dhënë dëshminë e tij përpara Ardian Brahos. Në lidhje me këtë çështje, ish-ministri është shprehur për News24 se dëshmia e tij u bazua në prova reale dhe të dokumentuara. "Ishte një sqarim i bazuar në prova reale e të dokumentuara që unë i dhashë prokurorisë së Tiranës, e cila po heton përsëri çështjen "CEZ", për çka lidhet me të ashtuquajtura prova të reja, të paraqitura nga komisioni hetimor parlamentar "Balla". Shpresoj që dëshmia ime ta ketë ndihmuar hetimin e prokurorisë për të dalluar të vërtetën e dokumentuar nga akuzat qesharake që prodhon kuzhina politike shqiptare". Kjo ishte dëshmia e dytë për dosjen, pas asaj të Shkëlzen Berishës në datën 1 shkurt. Shkëlzen Berisha pak ditë pas dëshmisë së dhënë në prokurorinë e Tiranës u shpreh se rihapja e hetimeve për privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga kompania CEZ është vetëm një shashkë politike e Edi Ramës për të mbuluar vjedhjen e tij në qeverisje. Djali i ish-kryeministrit është shprehur i bindur se ky proces hetimor ndaj tij do të dështojë si i mëparshmi. "Edi Rama, kryegjykatësi dhe kryeprokurori i ri i Shqipërisë, në pamundësi për të gjetur një prokuror, gjykatës apo dhe agjenci shtetërore që do merrte përsipër të bënte një kallëzim pa prova e fakte, u detyrua t'ia servitë këtë çorbë, të vetmes specie, që mund ta gëlltiste. Tualletit të tij parlamentar. Me gjithë presio-



Genc Ruli

GENC RULI

"Ishte një sqarim i bazuar në prova reale e të dokumentuara që unë i dhashë prokurorisë së Tiranës, e cila po heton përsëri çështjen "CEZ", për çka lidhet me të ashtuquajtura prova të reja, të paraqitura nga komisioni hetimor parlamentar "Balla". Shpresoj që dëshmia ime ta ketë ndihmuar hetimin e prokurorisë për të dalluar të vërtetën e dokumentuar nga akuzat qesharake që prodhon kuzhina politike shqiptare", -u shpreh ish-ministri Ruli.



SHKËLZEN BERISHA

Njëlljoi siç kam vepruar 4 herë përgjatë teatrit të komisionit hetimor, si qytetar dhe në respekt të ligjit, i jam përgjigjur fluskë-thirrjes së fabrikuar nga kryeprokurori i narkoshtetit për të dhënë të njëjtat përgjigje që kam dhënë para medias sa herë që kam dalë nga komisioni, që aktiviteti im, të ardhurat e mia, puna dhe veprimtaria ime, nuk kanë asnjë lidhje me privatizimin e OSSH", -shkruan Shkëlzen Berisha, personi i parë që dëshmoi për çështjen "CEZ", pas rihapjes së hetimeve.



nin politik, prokuroria nuk pati asnjë rrugë përveç se ta pushonte kallëzimin në fjalë. Gënjeshtra për gjoja një

premtim takim që dy persona pa asnjë lidhje me mua, i bënin njëri-tjetrit, doli se ishte bërë plot 9 muaj pas për-

fundimit të procesit të privatizimit, që do të thotë që ky takim (që nuk ka ndodhur kurrë) nuk kish se për çfarë

RIHAPJA E HETIMIT

Dosja "CEZ" u mbajti për afro dy vite më duar nga prokuroria e Tiranës dhe në përfundim firmosi për pushimin e çështjes. Pak javë më parë, gjykata vendosi ta shfuqizojë vendimin e organit të akuzës dhe ta kthejë sërish çështjen për hetim, duke lënë detyra konkrete për grupin hetimor.

të ndikonte. Pavarësisht instrumentalizimit politik dhe mungesës absolute të fakteve. Njëlljoi siç kam vepruar 4 herë përgjatë teatrit të komisionit hetimor, si qytetar dhe në respekt të ligjit, i jam përgjigjur fluskë-thirrjes së fabrikuar nga kryeprokurori i narkoshtetit për të dhënë të njëjtat përgjigje që kam dhënë para medias sa herë që kam dalë nga komisioni, që aktiviteti im, të ardhurat e mia, puna dhe veprimtaria ime, nuk kanë asnjë lidhje me privatizimin e OSSH", shkruan Shkëlzen Berisha. Dosja CEZ u mbajti për afro dy vite më duar nga prokuroria e Tiranës dhe në përfundim firmosi për pushimin e çështjes. Pak javë më parë, gjykata vendosi ta shfuqizojë vendimin e organit të akuzës dhe ta kthejë sërish çështjen për hetim, duke lënë detyra konkrete për grupin hetimor.

SHKURT

Grupi i drogës "Treblova", prokuroria kërkon 29 vite burg për 4 të arrestuarit

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dhënë ditën e djeshme pretendencën për 4 të arrestuarit e grupit "Treblova" në Vlorë. Organi i akuzës kërkojë në total 29 vite burg për të pandehurit. Konkretisht 9 vjet burg për Taulant Haxhirajn, 8 vjet burg për Shkëlqim Koçiajn, 8 vjet burg për Marjus Bajramin dhe 4 vjet burg për Xhovalin Bacon. Të pandehurit përfitojnë uljen e një të tretës së dënimit për shkak se çështja po gjykohej me kohë të shkurtuar. Ata akuzohen për "Kultivim të lendeve narkotike në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal", "Kryerjes së veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal". Së bashku me këtë grup kriminal u kap dhe ish-policin Renato Avdylli, por gjykimi ndaj tij u pushua te Krimet e Rënda për t'u transferuar në Vlorë. Ky grup u prangos në korrik të vitit 2016 ndërsa asokohe pati dhe një përplasje me prokurorisë dhe policisë në lidhje me masinë e sekuestruar të drogës. Gjatë arrestimit të të pandehurve një vit më parë, u sekuestruan plot 7250 rrethë kanabis në fshatrat Vezhdanisht-Treblovë. Ndërkohë në këtë grup janë ende në kërkim dhe dy shtetas mes tyre Gjovalin Baco dhe Reshat Radhima.

Grabitja në Rinas, Krimet e Rënda zgjasin me 3 muaj hetimin për bandën

Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkojë ditën e djeshme zgjatjen e afateve hetimore për autorët e dyshuar si grabitësit e blindave me para të bankave të nivelit të dytë në aksin Tiranë-Rinas. Kjo kërkesë u miratua nga gjykata e Krimeve të Rënda me tre muaj zgjatje hetimesh, konkretisht për Fatjon Xhuliu, Neim Avdyllajn, Diqon Memlikajn, Admir Çepjan, Dash Kupën, Ernest Kupën, Dritan Sinanin dhe Aleksander Muratajn. Ndërkohë që është ende në kërkim shtetasi Admir Murataj. Mësohet se avokatët mbrojtës të shtetasve të sipërpërmendur kanë kundërshtuar zgjatjen e hetimeve duke kërkuar një arsye për këtë zvarritje. Avokatët theksuan me tej se do të apelojnë këtë vendim. Ndërsa argumenti i prokurorisë për zgjatjen e afatit është bërë për shkak të pritjes së përgjigjeve të letërporsive të kompanive celulare për komunikimet e të pandehurve. Rreth një vit më parë u grabit me armë blindi i një banke të nivelit të dytë. Autorët morën rreth 2 milionë euro.

Fshehu të ardhurat, dosja e Pezës regjistrohete Krimet e Rënda

Çështja në ngarkim të ish-deputetit Alfred Peza u regjistrua ditën e djeshme tek Krimet e Rënda. Peza akuzohet për fshehjen e të ardhurave dhe mosdeklarim pasurie. Seanca e parë gjyqësore ndaj ish-deputetit do të mbahet më 16 shkurt tek Krimet e Rënda ndërsa me short është përzgjedhur gjyqtari Klodian Kurushi. Çështja ndaj Pezës mbërriti të Krimet e Rënda, pas shpalljes së moskompetencës nga Gjykata e Lartë pak muaj më parë. Veç akuzës për fshehje të ardhurash ish-deputeti Peza do të gjykohej dhe për pastrim parash dhe mos deklarim pasurie. Peza u hetua nga prokuroria pas publikimeve në media të kontratës së blerjes së 1% aksione në vlerën e 1 mln eurove pranë një banke të nivelit të dytë. Prokuroria ka sekuestruar në prill të 2017, aksionet e bashkëshortes së ish-deputetit në një bankë në kryeqytet me vlerë 113 mln lekë. Sekuestrimi i pasurisë në prill të vitit të kaluar është bërë për akuzën "fshehje e të ardhurave", "pastrim i produkteve të veprës penale" dhe "mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive".



United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancies:

Posts Titles:

- 1- Team leader for mid-term review of the implementation of the National Employment and Skills Strategy 2020
- 2- National Consultant – Mid-term review of the implementation of the National Employment and Skills Strategy 2020 for Albania
- 3- National Consultant – Assess developments and draft the Annual Progress Report 2017 in the employment and skills sector
- 4- National Consultant - Monitoring and Reporting
- 5- National Expert - Quality Assurance in VET
- 6- Legal Expert
- 7- Senior private sector expert

Type of Contract: Individual Contract

Project: Skills Development for Employment Programme

Duty Station: Tirana, Albania

Deadline for Application: February 19, 2018

Job Description: <http://al.undp.org>

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>.

Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.



Kryeprokurorja Arta Marku

Arta Marku në Durrës: Është rritur agresiviteti i grupeve kriminale

DURRËS-Kryeprokurorja Arta Marku ka marrë pjesë në analizën e prokurorisë së rrethit Durrës ku ka dhënë direktiva si dhe porosi. Kryeprokurorja Marku tha se qyteti i Durrësit si një nga qytetet porte të vendit tonë rezultojn me shumë pak vepra penale në fushën e kontrabandës. "Ndërkohë që jemi të vetëdijshëm se sjell-

jet që cenojnë legjislacionin doganor janë të shumta dhe të ndëshkueshme penalisht. Duhet që edhe kryesisht prokurorët të angazhohen për të evidencuar këto vepra penale në çështjet që heqojnë, duke mos u mbetur të kufizuar vetëm në referimit që mund të vijë nga policia e shtetit apo vetë doganat", tha Marku. Kryeprokurorja

u shpreh, gjithashtu, se konstatohet se ka një ulje të veprave penale kundër jetës, por ka një rritje të agresivitetit nga grupet kriminale në kryerjen e këtyre veprave penale. "Konstatohet se ka një ulje të veprave penale kundër jetës, por ka një rritje të agresivitetit nga grupet kriminale në kryerjen e këtyre veprave penale. Au-

torët në funksion të realizimit të qëllimeve të tyre kriminale janë të gatshëm të sakrifikojnë çdokënd që mund të jetë rastësisht në rrezen e tyre të veprimit. Kjo vjen nga mosndëshkimi, apo ndëshkimi i lehtë dhe jo proporcional me krimin e kryer dhe rrezikshmërinë e autorit. Veprat penale kundër korrupsionit janë shumë pak të regjistruara dhe aq më pak kanë përfunduar "dhe gjykim", u shpreh Marku.

Të pandehurit nën akuzë për "Vrasje me dashje", e mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje

Në kërkim për tentativë vrasjeje, ndalohen dy të dyshuarit

Ranë në pranga 28-vjeçari Sergeto Turullaj dhe Edmond Mamushi

TIRANË

Në vijim të punës për kapjen dhe ndalimin e shtetasve të shpallur në kërkim, policia Tiranë ka vënë ditën e djeshme në pranga dy persona të akuzuar për vrasje të mbetur në tentativë, armëmbajtje pa leje si dhe vjedhje. Nga të dhënat zyrtare mësohet se është ndaluar nga shërbimet e pol-



icisë, shtetasi Sergeto Turullaj, 28 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar me parë. Gjithashtu, është arrestuar shtetasi Edmond Mamushi, 41 vjeç, banues në Përmet.

ARRESTIMET

28-vjeçari Sergeto Turullaj ra në prangat e policisë pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 05.05.2017, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për të. Turullaj akuzohet për veprën penale "Vrasja me dashje", e mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit". Po ashtu Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Durrës, më datë 28.04.2017, ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj tij, për veprën penale "Vjedhja e kryer në bashkëpunim", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit". Kjo pasi në 15 prill të vitit që shkojë në rrugën "Kongresi i Përmetit" shtetasi Sergeto Turullaj në bashkëpunim me shtetasin D. Y., kanë tentuar të vrasin shtetasin L.SH. Ndërkohë më datë 26.04.2017 ky shtetas në bashkëpunim dyshohet të ketë vjedhur disa banesa në qytetin e Durrësit. Në vijim të operacioneve poli-

core për ndalimin e personave të shpallur në kërkim, shërbimet e komisariatit nr. 4 kanë kapur shtetasin Edmond Mamushi, 41 vjeç, banues në Përmet. Arrestimi i tij u krye pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, ka caktuar ndaj Mamushit, masën e sigurisë "Arrest me burg", për veprat penale "Vrasja me paramendim", e mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit". Në 16 nëntor të vitit 2016 Mamushi për motive hakmarrje ka tentuar të vrasë me armë zjarror në qytetin e Përmetit shtetasin J.H..

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services and "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM)

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. The realisation of the EU action "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM) delegated to GIZ aims at implementing the second component of "IPA 2016 - Support to Water Management" sector programme, which seeks to enhance the implementation of the National Water Reform and the progress of Albania towards EU water legislation requirements. The specific objective of the EUSWAM Action is to reduce pollution in Adriatic coastal water via strength-ened capacities and operation and maintenance of waste water infrastructure along the coast and in particular in selected municipalities that have benefited from EU support for the development of their waste water management infrastructure.

For the support of the EU/GIZ programme team GIZ Office Albania seeks the following staff:

Cleaner

Office services

The cleaner:

- cleans the office premises, rooms, furniture, carpets and windows
- checks and refills office supplies and articles in the kitchen and WCs
- sets up and prepares the conference rooms as instructed
- provides services at meetings, e.g. serves coffee and tea for guests and visitors
- reports if stocks, e.g. of beverages are low, and need to be replaced
- prepare small lunch for programme staff (including purchase)
- assists with other office work

Qualifications:

- Primary school education
- At least 2-4 years' work experience in a comparable position
- Good communication skills
- Basic knowledge of English or German

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: 2 years

Please forward your application until **21st of February 2018** to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: CV in English (Euro Pass format), **references**.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews.
GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

"Përhëndetje nga ky vend i mallkuar ku jam"

Kthimi në Shqipëri i Izet Haxhias: Në djall ekstradimi, rroftë dashuria

Pas vendimit nga gjykatat turke për ekstradimin e ish-truprojës së Sali Berishës, Izet Haxhia në Shqipëri, ky i fundit reagon nëpërmjet një statusi në rrjetin e tij social "Facebook". "Ne djall vafte ekstradimi! Rroftë Dashuria !!! Përhëndetje Franca..", shkruan Haxhia në "Facebook". Përkrah mesazhit, ai ka postuar edhe një këngë të Bujar Qamilit dhe Rosela Gjylbegut. Gjithashtu, ai ka komunikuar me komentuesit, njërit prej të cilëve i është përgjigjur se e vetmja gjë që i jep forcë është dashuria dhe këtë fakt s'mund ta ndalë as burgju. "E vetmja gjë që më jep forcë dhe më bën të pamposhtur është dashuria, vetëm ajo mund të çajë çdo errësi dhe të ndriçojë rrugën e të ardhmes dhe vërtetës. Asnjë burg apo ekstradim nuk mund ta ndalojë dashurinë.. Të përhëndes nga ky vend i mallkuar ku jam", shkruan Haxhia. Ish-

truproja i Sali Berishës akuzohet për vrasjen e ish-deputetit të PD Azem Hajdari. Ai është dënuar nga gjykata shqiptare me 25 vite burg. Ish-truproja i Berishës, Haxhia është dënuar nga gjykata shqiptare me 25 vite burg lidhur me vrasjen e ish-deputetit demokrat Azem Hajdari në 1998-ën, akuzë që nuk e ka pranuar asnjëherë.

Ai u arrestua në Turqi në vitin 2006, por arriti të fitonte betejën gjyqësore dhe drejtësia e vendit turk ka urdhëruar që ai të mos largohet nga vendi, duke penguar edhe ekstradimin deri më tani. Ditën e djeshme gjykata turke vendosi që të lejonte ekstradimin e tij drejt Shqipërisë.

FIQIRI XIBRI

"DO HYJMË NË KRYEMINISTRIN"

"Që prej 2007 ne po luftojmë për të drejtat tona, por qeveritë kanë shkelur ligjin në mënyrën më skandalozë dhe me paturpësinë më të madhe vijnë e i thonë minatorëve që projektligji për statusin bie në kundërshtim me procedurën. Ky është paralajmërim për qeverinë, kanë afat 30 ditë që të ulin të diskutojnë me sindikatën, në të kundërt do shkojmë brenda në zyrën e kryeministrit, sepse kemi parë vetëm tallje për vite me radhë", - u shpreh kreu i Sindikatës së Minatorëve, Fiqiri Xibri për "Gazeta Shqiptare".



MARK GJERGJI

"NA KANË SHKELUR BARBARISHT"

"Ne nuk do të dorëzohemi, por do të luftojmë për të drejtat tona deri sa të jemi gjallë. Na premtuan që do miratohet brenda janarit të 2018-ës, e tani na e shtynë sërish. Kjo është një poshtërsi e një gënjeshtëri e radhës që ka shkaktuar indinjatë e revoltë në radhët e minatorëve. Protesta do jetë e pandërprerë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, pra miratimin e statusit. Jemi një kategori që ka hequr plot vuajtje e jemi shkelur barbarisht nga pushtetarët", -thotë për "GSH" minatori Mark Gjergji.



PRENG RAMA

"KAM PËRFUNDUAR ME BORXHE"

"Prej 17 vitesh kam punuar në minierën e Spaçit. Kemi punuar në kushte çnjerëzore dhe e vetmja gjë që kërkoj është të vihet në vend dinjiteti që na takon për gjithë ato vite që kemi sakrifikuar në nëntokë e madje kemi vënë edhe jetën në rrezik. Tani marr një pension prej 150 mijë lekësh të vjetra e shumë herë përfundoj edhe me borxhe. Jetoj vetë i tretë e nuk mbylлим dot as muajin me këto të ardhura, varfëri ekstreme", -tregon për "GSH" një tjetër minator në pension, Preng Rama.



MEHMET ISMAILI

"VLEJMË SA NJË ZAGAR"

"Kam punuar në Tropojë për 17 vite e të bësh një jetë të tërë në minierë e të përfundosh me 150 mijë lekë të vjetra pension; ky është kulmi. S'ka minator që nuk preket nga sëmundjet shëndetësore, kush më shumë e kush më pak. Vlera jonë në ditët e sotme është sa një zagar, pavarësisht frontit aq të vështirë të punës. Ne jemi pjesë e këtij populli, jemi shqiptarë e nuk arrij ta kuptoj sesi kanë moral këta politikanë të na kërkojnë votën, por asnjë prej tyre nuk është bir minatori", -tregon Mehmet Ismaili për "GSH".



HAMIT MZHIKA

"E MERITOJMË STATUSIN"

"Kam punuar plot 16 vite nëntokë e në moshën 16 vjeç kam filluar për herë të parë në minierën e bakrit në Kurbnesh. Kam parë shokët e mi të më vdesin para syve dhe asnjë pushtetar s'na i ka qarë hallin, madje më ka vdekur edhe një prej vëllezërve nga sëmundja profesionale që e kapi në minierë. Ato 160 mijë lekë të vjetra që na jep shteti nuk na dalin as për të ngrënë bukë, është turp që nuk vlerësojnë kontributin që ne kemi dhënë për atdheun. Ne e meritojmë miratimin e statusit, nuk kërkojmë mëshirë, por vetëm çka na takon", -tregon Mzhika për "GSH".



QANI SHINO

"MJAFT MË ME TALLJE"

"Kam punuar prej 13 vitesh në minierën e Valiasit, e pensioni qesharak nuk shkon as 160 mijë lekë të vjetra. Kërkojmë që pensioni minimal të jetë jo më pak se 300 mijë lekë të vjetra, e të miratohet statusi i tij. Shteti mund ta përballojë më së miri këtë por duan të vjedhin e të pasurohen. Kemi bërë rreth 59 protesta por ende nuk po shohim asgjë që të funksionojë siç duhet, boll më me tallje e me shkelje", -tregon për "GSH" Qani Shino, minator në pension.



Kreu i sindikatës Fiqiri Xibri: Shkelje ligji në mënyrë skandalozë, tallje për vite me radhë

Mbi 150 minatorë protestë para parlamentit

"Të miratohet statusi, pensionet qesharake nuk mjaftojnë"



Voltiza Duro

Rreth 150 minatorë nga e gjithë Shqipëria kanë protestuar ditën e djeshme para parlamentit ku i kanë lënë afat qeverisë 30 ditë për miratimin e statusit. Kjo protestë e punonjësve të nëntokës vjen pas rrëzimit të projektligjit për statusin e minatorit nga Komisioni i Çështjeve Sociale dhe Shëndetësive. Ata njëzëri kanë bërë thirrje për rritjen e pensioneve të minatorit dhe mbulimin e vizitave mjekësore nga ana e shtetit, e më tej, kanë paralajmëruar përshkallëzimin e qëndresës nëse nuk merrren parasysh kërkesat e tyre. "Është e pakuptimtë që minatori që ka punuar 12 vite e 6 muaj del në pension në moshën 55 vjeçare, ndërsa ai që ka punuar qoftë edhe një muaj më pak del në pension në 65 vjeç. Pra, kërkojmë që të bëhet përshkallëzimi, që do të thotë 1 vit më pak në punën nëntokë, minatori të mos dalë 55 vjeç në pension, por në 56 vjeç", -u shpreh kreu i Sindikatës së Minatorëve, Fiqiri Xibri për "Gazeta Shqiptare". Më tej ai theksoi se minatorët kërkojnë pensionin minimal



Protesta e minatorëve para parlamentit



NAFTËTARËT NË PROTESTA, SHKAK PAGAT

Edhe naftëtarët e uzinës së ARMO-s në Ballsh, po organizojnë protesta të njëpasnjëshme pasi prej më shumë se 16 muaj ata nuk kanë marrë pagat e tyre. Edhe pse shumë prej tyre kanë marshuar drejt kryeqytetit në këmbë në shenjë revolte, ende problemi i tyre nuk ka marrë një zgjidhje përfundimtare. Naftëtarët paralajmëruan se, nëse kërkesat e tyre nuk plotësohen për pagat e prapambetura ata do të përshkallëzojnë protestën deri në grevë urie.

në masën 140% të pagës minimale, pra diku te 350 mijë lekë si dhe pagat minimale në minierë të jenë jo më pak se dyfishi i pagës minimale

në rang vendi. "Garda e nëntokës" prej 10 vitesh bën thirrje për plotësimin e kërkesave por sipas minatorëve, deri më tani, të

gjitha qeveritë ndër vite, nuk kanë marrë mundimin të ulen e të diskutojnë me këtë kategori. "Që prej 2007 ne po luftojmë për të drejtat

tona, por qeveritë kanë shkelur ligjin në mënyrën më skandalozë dhe me paturpësinë më të madhe vijnë e i thonë minatorëve që projektligji për statusin bie në kundërshtim me procedurën. Ky është paralajmërim për qeverinë, kanë afat 30 ditë që të ulin të diskutojnë me sindikatën, në të kundërt do shkojmë brenda në zyrën e kryeministrit sepse kemi parë vetëm tallje për vite me radhë", -shtoi Xibri. Të indinjuar e të revoltuar, 150 minatorët të grumbulluar para parlamentit kanë kërkuar që zëri i tyre këtë herë të dëgjohej e të mos lihet në harrësë, siç ka ndodhur këto 10 vitet e fundit.

KËRKESAT

"Jemi këtu sot për të paralajmëruar qeverinë se pavarësisht të drejtave të shkelura, ne nuk do të dorëzohemi por do të luftojmë për të drejtat tona deri sa të jemi gjallë. Na premtuan që do miratohet brenda janarit të 2018-ës, e tani na e shtynë sërish", shprehet minatori në pension, Mark Gjergji në një prononcim për Gazeta Shqiptare. Punonjësit e nëntokës, thonë se deri më tani janë gënjyer nga qeveritë e të gjitha viteve, si dhe nga vetë sindikatat. "Prej 17 vitesh kam punuar në minierën e Spaçit. Kemi punuar në kushte çnjerëzore dhe e vetmja gjë që kërkoj është të vihet në vend dinjiteti që na

takon për gjithë ato vite që kemi sakrifikuar në nëntokë e kemi vënë jetën në rrezik. Tani marr një pension prej 150 mijë lekësh të vjetra e shumë herë përfundoj edhe me borxhe. Jetoj vetë i tretë e nuk mbylлим dot as muajin me këto të ardhura, varfëri ekstreme", -tregon për "GSH" një tjetër minator në pension, Preng Rama. Ndërkohë një tjetër punonjësi i gardës së nëntokës thekson se vetëm një minator mund ta kuptojë punën në minierë dhe gjithmonë që hynin në galeri shpresonin të dilnin gjallë që aty. "Kam punuar në Tropojë për 17 vite e të bësh një jetë të tërë në minierë e të përfundosh me 140 mijë lekë të vjetra pension ky është kulmi. S'ka minator që nuk preket nga sëmundjet shëndetësore, kush më shumë e kush më pak. Vlera jonë në ditët e sotme është sa një zagar, pavarësisht frontit aq të vështirë të punës", -tregon minatori Mehmet Ismaili për "GSH". Më tej ai shprehet se dhe në kohën e diktaturës vlerësoheshin më shumë sesa sot e kërkon që zëri i tyre të dëgjohej nga shteti shqiptar. Një tjetër minator në pension, Qani Shino shprehet se e kujton si sot ditën kur shoku i tij minator, një 26 vjeçar nga Vlora, humbi jetën në galerinë e nëntokës. "Shokët tanë kanë vdekur; e ne kemi rrezikuar jetën së tepërmi. Më pak tallje e më shumë respekt", -thotë ai për "GSH".

Fondi, kundër qeverisë për Partneritetin Publik Privat për ndërtimin e rrugëve

FMN: 'Jo' rrugëve me koncesion

Rekomandimi: Ja si duhet t'i gjeni burimet e financimit

Ornela Manjani

Fondi Monetar Ndërkombëtar shprehet katërorikisht kundër ndërtimit të rrugëve me koncesion nga kompani private. Në kohën që qeveria vetëm pak ditë më parë firmosi kontratën koncesionare për ndërtimin e Rrugës së Arbrit dhe lajmëroi edhe koncesione të tjera në këtë drejtim, FMN del sot me një analizë të detajuar, ku u tërheq vëmendje të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas FMN-së, mënyra e duhur e financimit të rrugëve nuk është ajo me Partneritet Publik Privat, sidomos për vendet që kanë një borxh të lartë, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Ekspertët e Fondit rekomandojnë se nuk duhen projekte të ekzagjeruara dhe të dobëta, por planifikime të sakta dhe tërheqje e donacioneve dhe financime nga jashtë. FMN bën thirrje që projektet në infrastrukturë të mos politizohen dhe të rritet bashkëpunimi mes vendeve të rajonit. Një alternativë tjetër që sugjeron Fondi Monetar për të gjetur financime është edhe zgjerimi i bazës tatimpaguese, nëse ka hapësira.

RAPORTI

Raporti shprehet kritik me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, duke thënë se kanë rrjete të pazhvilluara të transportit, energjisë dhe telekomunikacionit. Sipas FMN, mungesa e infrastrukturës publike të rajonit shihet edhe si pengesë e madhe për rritjen ekonomike të vendeve. Vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia) kanë rrjete të pazhvilluara të rrjetit të transportit, energjisë dhe telekomunikacionit krahasuar me mesataren e Bashkimit Europian (BE), konstaton Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në një punim të fundit "Infrastruktura Publike në Ballkanin Perëndimor: Një rrugë drejt të ardhurave më të larta". Mbyllja e hendekut të infrastrukturës publike do të ndihmojë rajonin të arrijë standardet e jetesës në Evropën Perëndimore. Por, nga do të vijnë paratë? Rritja e financimit do të jetë e nevojshme si nga burimet vendore, edhe ato të huaja. Një planifikim i mirë për zbatimin e projekteve të investimeve publike është gjithashtu një domosdoshmëri - thotë një raport i fundit. Konvergjenca e të ardhurave drejt niveleve të BE-së është ngadalësuar ndjeshëm në Ballkanin Perëndimor që nga kriza globale financiare. Zhvillimi ekonomik i rajonit po ecën ngadalë. Nëse vendet do të mbyllin hendekun në stan-

FINANCIMET

Forcimi i kapaciteteve planifikuese, mospolitizimi i projekteve, bashkëpunimi rajonal, tërheqja e donacioneve, sigurimi i financimeve të jashtme, zgjerimi i bazës së taksapaguesve dhe mosrrezikimi i stabilitetit makroekonomik janë disa prej burimeve që mund të përdoren qëveria.



dardet e jetesës me BE-në, ata do të duhet të gjejnë një mënyrë për të riaktivizuar rritjen ekonomike. FMN ka identifikuar infrastrukturën publike të munguar të rajonit si një pengesë të madhe për një rritje më të lartë ekonomike. Rrjetet më të mira të transportit, energjisë dhe telekomunikacionit do të ndihmonin vendet e Ballkanit Perëndimor të rrisnin produktivitetin, të

integrohen më thellë në tregtinë globale dhe të përmirësonin atraktivitetin e rajonit për investimet e huaja. Analiza tregon se një përmirësim i infrastrukturës publike të koordinuar rajonale, së bashku me menaxhimin më të mirë të projekteve aktuale mund të rrishte ndjeshëm të ardhurat për frymë. Fitimi afatgjatë i PBB-së reale për person mund të jetë deri në 3-4 pike

përqindjeje. Por, arritja e BE-së në nivelet e infrastrukturës është e vështirë, investimet publike kërkojnë burime të mjaftueshme buxhetore dhe korniza të forta institucionale që rregullojnë përzgjedhjen, ekzekutimin dhe monitorimin e projekteve. Këto dy kushte kryesisht mungojnë në Ballkanin Perëndimor. Shumica e vendeve në rajon tashmë kanë nivele të larta të borxhit publik dhe disa gjithashtu kanë deficite të larta buxhetore. Vështirësia e përgjithshme të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit kufizon likuiditetin. Menaxhimi i investimeve publike është gjithashtu i dobët.

FMN JEP MË PAS REKOMANDIMET PËR SIGURIMIN E FINANCIMEVE:

1. "Investimi në investime": forcimi i kapaciteteve për të planifikuar, zgjedhur dhe kryer projektet e infrastrukturës do të sigurojnë që burimet në dispozicion të përdoren më mirë dhe do të përmirësonin aftësinë e rajonit për të absorbuar financimin e donatorëve në dispozicion. E rëndësishme është që projektet e infrastrukturës të mos bien viktimit e politizimit. Vendet mund ta shmangin atë duke vendosur afate të investimeve publike bazuar në qëllime konkrete, të matshme dhe metodologji transparente të vlerësimit.
2. Shumë rrjete të infrastrukturës shtrihen përtej kufijve. Për këtë arsye, koordinimi më i mirë rajonal i projekteve të investimeve do të jetë i thelbësor. Qeveritë mund të krijojnë hapësira të mëtejshme për manovrim, duke zgjeruar bazën e tyre tatimore (duke eliminuar përjashtimet dhe stimujt e taksave) dhe forcimin e pajtueshmërisë së taksave, të cilat rezultojnë me më shumë të ardhura të mbledhura.
3. Financimi i jashtëm duhet të luajë një rol më të madh në zhvillimin e infrastrukturës publike në Ballkanin Perëndimor, duke lënë hapësirë që burimet e brendshme financiare t'u shërbejnë nevojave të sektorit privat. Donatorët zyrtarë, financimi shumëpalësh dhe dypalësh në kushte koncesionare do të duhet të luajë një rol dominues, veçanërisht në vendet me borxh të lartë publik.
4. Vendet nuk duhet të rrezikojnë stabilitetin e tyre të përgjithshëm makroekonomik nga projektet infrastrukturorë publike të ekzagjeruara ose të dobëta. Ndikimet në rritjen ekonomike, inflacionin dhe deficiteve të jashtme të llogarisë rrjedhëse duhet të jetë një element kyç i çdo diskutimi të politikës për nxitjen e infrastrukturës publike në rajon.

Reforma për ujën

Uji, 20 litra falas për familjet në nevojë

Familjet në nevojë do të furnizohen me 20 litra ujë për frymë në ditë, pa pagesë. Gjithçka përcaktohet në kontratën e performancës që bashkitë do të duhet të lidhin me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimit, në kuadër të reformës në sektorin e ujit. Sipas tekstit të kontratës, ky është një prej indikatorëve të performancës së aksionit gjatë vitit 2018, mbi bazën e të cilave do të vlerësohen shoqëritë UK për marrjen e subvencioneve nga shteti. Vendimi u paralajmërua më herët edhe nga këshilltarja e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Lindita Sotiri, në TV "Scan". "Kuptohet që uji nuk është vetëm mall konsumi, është një e drejtë dhe një detyrim i qeverisjes për t'u ofruar këtë të drejtë qytetarëve. Ne jemi munduar të marrim të gjitha masat që shtresat në nevojë, që janë kategoritë më vulnerabil, të mos preken nga ky aksion dhe nga kjo reformë. Për të duhet që të tjerët që nuk jemi pjesë e këtyre kategorive, do të duhet që të reflektojmë dhe të kemi atë qasje që kemi për çdo mall që konsumohet. Pra, çfarë konsumojmë do të duhet ta paguajmë. Politika që kemi bërë ne në mënyrë që edhe nëse do të ndodhë kjo rritje çmimesh, të mos impaktojë shtresat në nevojë, pra qytetarët është që mbulojmë 20 litër për frymë në ditë, që është minimumi jetik i nevojshëm për shtresat në nevojë. Pra, kjo fashë do të përballohet nga qeverisja qendrore dhe pastaj, sigurisht që Enti Rregullator i Ujit është përgjegjësi kryesor për të mbrojtur konsumatorin, për të bërë një analizë që vjen nga bashkia përkatëse për të rritur apo jo çmimin", - tha Sotiri. Në kuadër të lehtësimit të familjeve në nevojë, pak javë më parë qeveria miratoi edhe vendimin që parashikon subvencionimin e tarifës së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë.



Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë miratoi dje tri masa, zbatimi i të cilave do të frenojë përdorimin e euros në ekonominë vendëse. Masat kanë të bëjnë me kufizimin e kredisë në valutë dhe rritjen e kërkesës për kapital në këtë valutë. Masa e parë është kufizimi i kreditit në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit. Kjo masë do të zbatohet nëpërmjet vendimit të Këshillit Mbikëqyrës "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Huat në valutë të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë) nuk duhet të kapërcëjnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel zbritet nga vlera e kapitalit rregullator. Masa e dytë është kërkesa për aktive likuide në valutë. Do të vendoset kërkesa minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyri-

Banka e Shqipërisë bën publike tri masat që kufizojnë përdorimin e euros



meve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan) dhe në total në nivelin 20%. Masa e tretë është kërkesa e lartë për kapital i raportit të depozitave në valutë të sektorit privat ndaj totalit të depozitave pranë sektorit bankar, prej rreth 53%, është dukshëm më lartë se niveli mesatar i këtij raporti për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria.

Ambasada: Ja ku duhet të tregoni kujdes, hapi i parë për t'u bërë banor i përhershëm

Vizat në SHBA, petition imigrimi për pjesëtarët e familjes

"Lexoni rregullat para aplikimit"

Voltiza Duro

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë për vizë në Shtetet e Bashkuara, duhet të tregojnë kujdes në leximin e rregullave para se të aplikojnë. Kjo është bërë me dije ditën e djeshme nga ambasada amerikane në kryeqytet, e cila ka theksuar se çdo pjesëtar i familjes i duhet një petition imigrimi. "Në më të shumtën e rasteve, çdo pjesëtar i familjes i duhet një petition imigrimi më vete. Sigurohuni që petitioni juaj në SHBA të lexojë me kujdes rregullat përpara se të dërgojë aplikimin për familjen tuaj", thuhet në njoftimin e ambasadës. Ndërkaq kjo e fundit citon, gjithashtu, se kohëzgjatja e shqyrtimit dhe mi-



ratimit të petitionit nga USCIS në përgjithësi zgjat rreth 7-8 muaj. Më pas ky petition i kalon Qendrës Kombëtare të Vizave (NVC), e cila kontakton aplikantin brenda rreth një muaji me dokumentacionin e kërkuar. Sa më shpejt dhe saktë që kandidati t'i përgjigjet NVC-së, aq më shpejt ajo cakton intervistën në Seksionin

Konsullor. Qytetarët e huaj që duan të jetojnë përgjithmonë në Shtetet e Bashkuara duhet së pari, të marrin një vizë emigrimi pasi ky është hapi i parë për t'u bërë banor i përhershëm i ligjshëm. Emigrimi në Shtetet e Bashkuara është një vendim i rëndësishëm dhe kompleks e për shkak se shumica e emigrantëve marrin viza në

kategoritë e vizave në familje ose punësim, ato janë në fokusin kryesor. "Për të qenë i përshtatshëm për të aplikuar për një vizë emigrimi, një shtetas i huaj duhet të sponsorizohet nga një shtetas i SHBA, një banor i përhershëm i ligjshëm i SHBA-së ose një punëdhënës i ardhshëm, me disa përjashtime. Sponsorin fillon procesin e emigracionit duke paraqitur një kërkesë në emër të shtetasit të huaj me Shërbimin e Shtetësisë dhe Imigracionit në SHBA (USCIS)", theksohet në faqen zyrtare të ambasadës. Marrëdhëniet familjare dhe llojet e veçanta të punësimit që mund të sponsorizohen për qëllime të emigracionit bazohen në ligjet e emigracionit të SHBA, të cilat përcaktojnë dy kategoritë e lejura të vizave të emigrantëve, kërkesat për përshtatshmërinë dhe procedurat.



Ministri për Median izraelite

Klosi: Brenda 5 vitesh, 60 mijë turistë nga Izraeli

Falë zgjerimit të ofertës turistike në tregje të reja si Izraeli, pritet që turizmi në Shqipëri e numri i të huajve që vizitojnë atë të pësojë rritje nga viti në vit. Kështu ka deklaruar ministri i Mjedisit e Turizmit, Blendi Klosi gjatë një interviste për median izraelite "Passport". "Qëllimi ynë është që brenda tre viteve të trefishojmë numrin e turistëve dhe brenda 5 viteve ta dhjetëfishojmë, gjë që do të thotë 60000 turistë izraelitë që do të vizitojnë Shqipërinë. Nuk kemi dyshim se numrat do të ngrihen kur izraelitët të fillojnë të njohin vendin tonë, bregdetin e mrekullueshëm prej 400 km, natyrën që të impresionon me bukuritë e saj, vizitat në vendet historike dhe kulinarinë e veçantë.", tha Klosi gjatë intervistës. Ai më tej theksoi se, gjatë 10 muajve të parë të 2017-ës, vizituan Shqipërinë 6.7 milionë turistë, një rritje drastike prej 1 milionë turistësh në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Ministri ndodhej për një vizitë në këtë shtet për të inauguruar linjën e re ajrore Tiranë-Tel Aviv, e cila do të operojë me dy fluturime në javë duke nisur nga muaji prill. I pyetur nga media izraelite mbi mungesat e personelit të sigurimit të IsraAir, Klosi garantoj se ky problem do të zgjidhet, pasi ka vullnet të përbashkët për funksionimin e linjës së re. "Bisedova dhe në panair me ministrin izraelit të turizmit, Jariv Levin dhe patëm një bisedë të mirë e të frytshme, në të cilën ai premtoi se ky problem do të zgjidhet", - u shpreh ministri Klosi.



Implemented by giz

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services and "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM)

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. The realisation of the EU action "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM) delegated to GIZ aims at implementing the second component of "IPA 2016 - Support to Water Management" sector programme, which seeks to enhance the implementation of the National Water Reform and the progress of Albania towards EU water legislation requirements. The specific objective of the EUSWAM Action is to reduce pollution in Adriatic coastal water via strengthened capacities and operation and maintenance of waste water infrastructure along the coast and in particular in selected municipalities that have benefited from EU support for the development of their waste water management infrastructure.

For the support of the EU/GIZ programme team GIZ Office Albania is looking for a:

Driver/logistic position

A. Responsibilities

The driver

- provides passenger transport in an official car for programme staff, official visitors and guests
- runs errands for the office, e.g. sending letters and messages, paying bills and buying smaller quantities of office supplies
- helps with transporting goods
- completes the vehicle log correctly and conscientiously in accordance with GIZ standards
- assists with other office work

B. Tasks

The driver

- cleans the interior and exterior of the vehicle(s) regularly
- checks oil, water, brakes and brake liquid, tyre pressure, battery levels and the entire vehicle regularly, headlights, brakes, bodywork for dents etc.
- is responsible for the project vehicle documents and their good condition, keeping a vehicle log and recording monthly maintenance
- calculates monthly petrol, oil and lubricant consumption for the daily cash fund and for forwarding monthly vouchers to cost accounting

- reports need for service and carries out minor repairs
- immediately reports all involvement of the project or office vehicle in accidents, including minor accidents, damage, loss or theft of vehicle fittings
- taking account of all available information on road conditions, accessible routes and locations

Knowledge management

The driver

- uses all available information (including current radio news on traffic conditions) to update daily knowledge of road conditions, current passable routes and locations, and shares this information with other office drivers

Other duties/additional tasks

The driver

- assists other colleagues as needed in other programmes if there is no travel pending, carries out other office work on request

C. Required qualifications, competences and experience

- secondary school education
- holds a valid driver's licence
- at least 5-7 years' work experience as a driver with references
- no major accidents in the past 3 years
- good knowledge of the English, ideally a knowledge of German
- discipline and punctuality
- resilience and patience
- appropriate appearance and attire (friendly manner with all passengers)
- ensures unrestricted availability of vehicles at all times and reports restrictions immediately
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana, regularly missions to local partners (3 Pilot cities and the coastal WWTPs/WUs and municipalities of the programme)
- Assignment period: 2 years

Please forward your application until **21st of February 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanienhr@giz.de, including the following information: CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

POLEMIKA

DEBATET PËR PËRKUJTIMIN

Elona Agolli: Kritikët smirëzinj, Dedaj: Lëreni Dritëronë të pushojë!

Fatmira Nikolli

(vijn nga faqja 1)

... të faktit se në të morën pjesë edhe emra nga politika e jo vetëm. Ndërsa Ndue Dedaj e ka quajtur "teprim me gjezte mirëdashëse" - mbjelljen e 20 pemëve dhe hedhjen e plisave nga Menkulasi (një gjest shumë simbolik) kryer nga miq e dashamirës të Dritëroit të madh, Elona Agolli thotë se "është mjaft i shqetësuar për shkrimet kushtuar emrit Dritëro Agolli në mediat serioze". Pas reagimit të Elonës, bijës së shkrimtarit, ka reaguar sërish, Ndue Dedaj në artikullin e mëposhtëm për "GSH", e cila botoi edhe reagimin e Elonës. Vëmë përballë dy reagimet.

ELONA AGOLLI

Mendime për një shkrim

Me një titull manipulativ, "Lëreni Dritëronë të pushojë", botuar ditën e sotme, autori Ndue Dedaj i afrohet lexuesit si shenjtor. Ditët që shkrimtari u nda nga jeta, një vit më parë, titull i tillë vihej re nëpër faqe gazetash për të mbrojtur emrin e sulmuar nga nihilistët e snobët (por edhe smirëzinjtë), të cilët kishin pritur pikërisht atë ditë për të jetuar "ëndërrën e tyre të përdhosjes". Zhurmonin sulmuesit e mbrojtësit dhe harronin që poeti i kishte menduar në gjallje të tij fushëbetajat e ziliqarëve dhe kishte servitur vargje për mbrojtjen e tij. E ndërsa shprehja "Lëreni të prehet i qetë" plot një vit më parë u drejtohej kundërshtarëve, sot kjo shprehje u drejtohet dashamirësve, të afërmeve, të dashurve, lexuesve, atyre për të cilët arti i shkrimtarit është ushqim shpirtëror në kohën e sotme të Ballajve e Habilajve. Autori Ndue Dedaj, vetë krijues, poet, publicist, historian letërsisë është mjaft i shqetësuar për shkrimet kushtuar emrit Dritëro Agolli në mediat serioze, pasi sipas tij është e panevojshme të publikohet "një e pathënë" e shkrimtarit (paçka se kjo "e pathënë" do t'i shërbejë një biografi apo jetëshkruesi për një libër apo një histori të letërsisë për faktet jetësore të shkrimtarit).

"Teprim me gjezte mirëdashëse" - e quan Ndue Dedaj mbjelljen e 20 pemëve dhe hedhjen e plisave nga Menkulasi (një gjest shumë simbolik) kryer nga miq e dashamirës të Dritëroit të madh. Ndërkohë që buste, emërtime rrugësh e institucioneve, me emra të panjohur apo qoftë edhe të njo-

hur, do të mund të pranoheshin heshturazi e pa komente.

Është shumë e vërtetë që vepra e madhe letrare e Dritëroit tejkalon çdo zë (dëvdues apo injorues), por nuk përbën kjo një arsye për të mos respektuar data e përkujtimore, për të mos marrë shkas nga këto data për të rrefyer ndodhi, kujtime, "të pathëna" të vetë shkrimtarit.

Mohimi i përkujtimit për të pohuar nevojën e një sipërmarrjeje më të thelluar siç është "nxitja e leximit të veprave 'në hije' të autorit, si "Trëndafil në gotë" etj., janë dy argumente që nuk ka pse të kundërshtojnë njëri-tjetrin. Le të shërbente ky vit përkujtimor, ku krahas dhimbjes njerëzore për ndarjen nga jeta të këtij personaliteti, të mund të sensibilizohet më tepër për vlerat dhe veprën e tij, të mund të ngrihet shqetësimi i drejtë që ky autor as në poezi dhe as në prozë nuk është i vendosur në listën e veprave për testin kombëtar të letërsisë. Kush tha që duke kujtuar poetin përmes mbjelljes së pemëve, kryebashkiaku tenton të krijojë panteonin e letërsisë shqipe? Nderimi nuk është kualifikim cilësish e vlerash. Apo ndoshta nëntekstet e kësaj kritike çojnë ujë aty ku është synimi final, presion dhe insistim për ngrirje iniciativash për vlerësim të figurave si Dritëroi? Autori i shkrimit arrin deri aty sa të cilësojë "stil të kapërcyer monist", përkujtimin e figurave të letërsisë, duke përgjithësuar rastin e përkujtimit të 1-vjetorit të parë të ndarjes nga jeta të Dritëroit.

REAGIMI I

NDUE DEDAJ

Sqarim për një shënim, apo shënim për një sqarim.

Lidhur me shkrimin tim të (par)dëshëm në gazetën "MAPO": "Lëreni Dritëronë të pushojë", ka reaguar e bija e Dritëroit Agolli, Elona. E mirëkuptoj shqetësimin e saj njëzëror, por unë nuk kam folur për familjarët e shkrimtarit, po për institucionet shtetërore, publike dhe disa të përditshme, që sipas meje, e teprojnë me publikimet kulturore për disa figura, teksta për disa të tjera nuk ndihen. Kam ngritur një problem dhe nuk kam "qortuar"



Dritëro dhe Elona Agolli

vetëm kryetarin e Veliaj për kopshtin e Dritëroit, por edhe ish-kryetarin Basha për bustin e Sabri Godës. Reaguesja e quan titullin e shkrimit tim "manipulativ", kur nuk është aspak i tillë. Nga ana tjetër, nuk e kuptoj se ç'lidhje ka me kontekstin e shkrimit tim, poezia e Agollit "Në kohën e Mirit të Xhikës", duke u rezervuar të shprehem për nivelin e saj artistik!

Zonja Elona duhet ta heqë merakun, se mos "nëntekstet e kësaj kritike çojnë ujë aty ku është synimi final, presion dhe insistim për ngrirje iniciativash për vlerësim të figurave si Dritëroi?" Aspak. Autori i shkrimit nuk çon ujë në mullirin e askujt, thjesht shpreh të lirë për atë që ndjen. Sa për thënimin agollian "Gjuha e zbulon dhe e mbulon njerinë", duke pyetur: "A do t'i shkonte ky aforizëm autorit të këtij shkrimi?", mund të them: Po, gjuha e zbulon e mbulon njerinë, nëse aforizma është e vlefshme dhe në rastin e shkrimit tim të para dy viteve: "Zylo", një meteor në kohë stuhie", që po ia pranëve këtij shënimi sqarues, që të publikohen së bashku, pasi artikulli në fjalë është me "sqarues" së çdo sqarim: "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" i Dritëro Agollit sikur është harruar, edhe pse ka qenë ndër të paktët tituj romanësh që nuk ishte e nevojshme të përmendej bashkë me emrin e autorit, ngaqë autor-libër ishin shkrirë në një. Agolli kishte kapur zemrëkron që e bënte burrokracinë të "kënduar", me një tallje të pamëshirshme ndaj saj. Demka i qahet së shoqes se raporto-mania e kishte sfumuar letërsinë tek ai, duke zhvlerësuar

kujtimin e fjalës, e cila tashmë ishte vetëm raport. Nuk ka kufi hipokrizia, depersonalizimi. Po çfarë ka mbetur nga Zylo? Edhe sot liderët politikë shkojnë gju me gju

me popullin, njëherë në katër vjet, kur vijnë fushatat elektorale. Shqiptojnë gjithë ditën e ditës ese të tipit Zylo, u pelqejnë t'u mbajnë çadrën, të bien fort boritë e makinave



Ndue Dedaj

kur kalojnë ata dhe trafiku të mbahet peng prej tyre. Atëherë ishte fjala "shoku", tash është fjala "shef". Sot nuk ka më Demka, që shkruajnë fjalime për shefat e mëdhenj, por ka sekserë që bëjnë pazare për shefat, ndaj sot do t'ia vlen të shkruhej "Shkëlqimi dhe mjerimi i sekserëve".

QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Vendi i punës: Menaxher Programi
Vendodhja: Tiranë
Afati i fundit i aplikimit: 15 shkurt, 2018

Organizata: Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (OSHPZH) është një organizatë jo-filimprurëse e angazhuar në ceshjtje e popullsisë dhe zhvillimit, përmes advokacisë për përmirësimin e legjislacionit dhe politikave të luses, ndërjegjesimit të publikut për të drejtat e tyre si dhe ndihjes dhe sigurimit të aksesit të barabartë për shërbime sociale dhe shëndetësore të arritshme e të përballueshme pavarësisht nga distanca apo statusi shoqëror.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Ndihmon në formulimin e politikave dhe programeve të organizatës, përcaktimin e objektivave dhe procedurave përkalëse për zbatim.
- Ndihmon për përdorimin eficient të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe artiljen e objektivave të organizatës.
- Ndihmon në drejtimin e veprimtarisë së përditshme administrative të organizatës.
- Mbikqort zbatimin e projekteve mbi bazën e planifikimit, buxhetimit, dhe proceset e monitorimit të projekteve.
- Së bashku me Drejtorin Ekzekutiv harton Planin e Punës Vjetor sikurse dhe bashkëpunon me Financieren për të planifikuar dhe buxhetuar, bazuar në objektivat dhe rezultatet që duhen arritur.
- Koordinon punën e koordinatoreve të projekteve, për të realizuar indikatorët e planifikuar.
- Siguron që aktivitetet e projektit të jenë në përputhje me politikat dhe rregulloret e OSHPZH-se.
- Harton projekte dhe dokumenta të shoqatës.
- Përgatit raporte progresive dhe finale siç kërkohet nga programi dhe raporton rregullisht tek Drejtori Ekzekutiv.
- Siguron shpërndarjen e gjere dhe vizibilitetin e artiljeve të programit.
- Përfaqëson kur është e nevojshme organizatën në takime dhe forume brenda e jashtë vendit.

KUALIFIKIMET DHE AFITESIT E KERKUARA

- Edukimi:**
 - Diplome Universitare Master, preferohet nivel shkencor dhe në fusha të lidhura me ceshjtjet sociale, dhe/ose në fushën e menaxhimit.
- Eksperience:**
 - Të paktën 5 vjet eksperiencë në Menaxhim Programi dhe/ose Projektesh në organizatat jo-filimprurëse, institucionet e administratës publike ose sektorin privat.
- Aftësi:**
 - Njohuri shumë të mira të kompjuterit.
 - Njohuri shumë të mira të Paketës Office (MS Word, Excel, etj.)
 - Preferohen njohurit në administrim database.
 - I/E afte të bëjë kërkime në internet.
 - Aftësi për të identifikuar dhe qartësuar ceshjtje, e për të dhënë mendime alternative.
 - Aftësi për të punuar në ekip, transparencë në punë.
 - Aftësi për të punuar nën presion, me orar të zgjatur dhe jashtë vendbanimit.
 - Aftësi të shkëlqyera në shkrim dhe komunikim verbal në gjuhën angleze. Çdo gjuhë tjetër është një plus për kandidatit.

Mirëpresim të gjithë kandidatët e interesuar, të dërgojnë elektronikisht në info@acd.org.al dokumentat e mëposhtme:

- leter molvimi,
- një kopje të jetëshkrimit (C.V),
- fotokopje e letërnjoftimit (kartës së identitetit),
- fotokopje e diplomës/diplomave shoqëruar me listë notash,
- dokumenta të tjera që vërtetojnë eksperiencën e kualifikime.

Afati i dorëzimit të dokumenteve është data 15 shkurt 2018. Kandidatët që do të kualifikohen nga plotësimi i kriterëve nëpërmjet shqyrtimit të dokumentave do të njohohen për kohën e testimit pranë organizatës.

DEBATI

Çfarë thanë dje Robert Ndrenika, Mehdi Malkaj, Mirush Kabashi, Arben Derhemi, Neritan Liçaj, Kastriot Çipi, Genc Fuga, Altin Basha, Romir Zalla, Taulanta Jupi, Laert Vasili

PËRSËRITET SKENARI I '99-ës

Artistët: S'jemi skllevër, hidhemi në grevë për Teatrin Kombëtar e kundër ligjit të Kumbaros

Ndrenika: Do shtrihem para teatrit, "Turbina" është për takime elektorale, jo për teatër

Fatmira Nikolli

Tiranë, 1999.

Edi Rama është ministër Kulturë. Në Tiranë zien ideja se Teatri Kombëtar do shembet, në truallin e tij një firmë ndërtime do të bëjë një pallat, 2 katet e para të të cilit do të jenë teatër. Artistët kundërshtojnë. Janë Violeta Manushi, Robert Ndrenika, Agim Qirjaqi e të tjerë në radhë të parë. Dë gjithë njëzëri: JO!

Para kësaj, si rrugë motivimi ishte bërë një ligj, një ligj të cilin artistët e cilësonin të mbrapshtë, pasi synonte t'i shndërronte institucionet në kompani private. Nisën tubimet, protestat, deklaratat, intervistat, deri në vendimin ekstrem: artistët hynë në grevë në godinën e Teatrit të Kukulave. Atëkohë po krijohej përshtypja se artistët do rrëzimin qeverinë!

Tiranë, 2018

Mirela Kumbaro është ministre Kulturë. Në Tiranë zien ideja se Teatri Kombëtar do zhvendoset te "Turbina" dhe së në truallin e tij me gjasë mund të ndërtohet një teatër i ri. Artistët kundërshtojnë. Violeta Manushi ka vdekur, po mbahet mend me "frazat" që përmendin e saj. Ka vdekur, edhe Agim Qirjaqi. Por, është gjallë dhe në radhë të parë, Robert Ndrenika. Një vit më parë i ka thënë ministres Kumbaro në një darkë se: "Nëse ndodh që godina e teatrit shembet, unë nuk do të tretrem në gropë, por do të shtrihem atje". Ditë më vonë, ajo i është përgjigjur se "nuk ke nevojë të shtrihesh atje".

Ndërkaq, në uebin e MK-së është hedhur një projektligj për artin që ka nxitur reagimin e ashpër të të gjithë artistëve, pa dallim partie, institucioni, "krahine e ideje" - ata nuk janë konsultuar dhe e cilësojnë si ligj që ngjan me ligjet komuniste.

Kanë nisur takimet, kundërshtimet, intervistat që premtojnë protestë e grevë. Nga Ministria e

Kulturës vjen një reagim që nuk thotë asgjë, një gjuhë e drunjtë "për të mirën e përbashkët".

TAKIMI: ARTISTËT KËRCËNOJNË PËR GREVA

Në takimin e dytë mes tyre, artistët të skenës dhe ekranit, i kanë kundërshtuar fort amendimet e bëra në ligjin "Për artin dhe kulturën". Artistët të bashkuar nën Sindikatën e Artistëve të Skenës dhe Ekranit, gjatë mbledhjes së hapur për mediat, kundërshtuan zhvendosjen tërësisht jotransparente të trupës së Teatrit Kombëtar tek Teatri "Turbina" dhe njëkohësisht amendimet në ligj që ata mendojnë se "cenojnë rëndë" statusin e artistit, sipas rendit të ditës, caktuar nga Kastriot Çipi. Më poshtë deklaratat e tyre të plota.

ROBERT NDRENIKA, "NDER I KOMBIT" E "TURBINA" QESHARAKE

Jam shumë i gëzuar që shikoj një mbledhje serioze sindikate, pasi kam menduar që është shumë e vështirë për aktorët që të kenë

Artistët: Le të rrezikojmë vendin e punës bojkotojmë shfaqjet dalim në protestë para Kryeministrit dhe Presidencës

një sindikatë dhe deri diku, këshutu ka qenë. Do përqendrohëm pak tek ndërtesa. Shumë vite më parë, edhe Partia e Punës thoshte që do bëjmë një teatër, i cili nuk u bë. Edhe këto 27 vjet, siç jeni vetë dëshmitarë, edhe pse keni qenë më të vegjël, është folur që do të bëhet një teatër dhe prapë nuk ka pasur pikë transparence. Di që prona juaj,

Mirush Kabashi: Ky ligj që ne kemi është më autokratik se në kohën e Ramiz Alisë

Teatri Kombëtar, është në një sipërfaqe prej 6-7 metra katrorë. Ajo është pronë e jona, e juaja dhe ish-të vjetërve. Kjo pronë gjatë viteve të demokracisë është vjedhur pjesërisht. Torre Drin ka ardhur në rrëzë të skenës. Ajo duhet të mbante distancë 10 metra. Kur të ndërtohet i ashtuquajturit teatër, ne duhet të tërhiqemi. Kjo është vjedhja e parë. Të gjitha dyqantë që janë ndërtuar pas kanë qenë pronë e teatrit. Vit pas viti ato janë privatizuar dhe tani privatët do të ndërtojnë kulla dhe aneks të jetë edhe teatri. Pra, vazhdon një vjedhje, sheshit. E kam thënë dhe them, që të gjitha kryeqytetet e Ballkanit, që i kam parë, kanë teatrat kombëtare, godina dhe infrastrukturë të mrekullueshme. Teatri ndërtohet një herë në 500 vjet. Brezi juaj dhe i imi mund të mos dimë të interpretojmë, mund të dalë ndonjë e të thotë: Hé, mo, ç'janë këta, por nuk mendohet që Shqipëria të rrijë pa aktorë. Godinat e teatrit të Beogradit, Bukureshtit janë 500-600-vjeçare, janë monumente kulturore. Këtu po ndërtohen xhamira e kisha dhe s'po ngrihet një teatër. Ia thashë dikujt dhe më tha që atë xhami po e ndërton Erdogani. Epo aq më mirë, sepse kisha dhe xhamia e shqiptarit është teatri dhe i takon shtetit shqiptar të ndërtojë një teatër që të jetojë 500-600, pse jo edhe 1000 vjet.

Prandaj këtë ne duhet ta kërkojmë nga shteti shqiptar. Atë "Turbinën" e pashë me miq, ajo është qesharake. Për teatër ajo nuk bën. Ajo është vetëm për ndonjë fushatë elektorale, në fund, prandaj ajo fjala që i thashë ministreshës, që do shtrihem para teatrit dhe që më ironizoi duke më thënë të vijë të shtrihet, të interpretojë tek "Turbina", paska qenë me vend. Ne nuk duhet të lejojmë të prisht ai teatër, pa marrë vesh se çfarë do të bëhet në të. Opera të mos guxojë të qaset. Mos keni shpresë tek këta analistët e mëdhenj, sepse në momente të caktuara, 20 vjet më parë, u bënë të gjithë me ministër dhe thoshin: "Ata duan ndërtesën e fashizmit, aty ku janë bërë gjyqet reaksionare", por

asnjeri nuk tha se atje është ndërtohet teatri, opera, filharmonia, estrada, të gjitha institucionet kulturore. Ai është edhe monument kulturore. I vetmi që na mbështeti ishte Patos Lubonja e Maks Velo e ndonjë tjetër. Të tjerët i kemi pasur kundra. Kjo është një çështje shumë serioze.

Dua t'u them se kësaj ministreshës i kërkova një herë ca para për të bërë një lapidar për "Spahivoglin", një nismë e ish-xënësve të tij, atje ku la kokat, në Mbrostare. Dhe na tha: "Nuk kam, na i kanë vjedhur qeveria paraardhëse"... ndërkohe që gjatë 27 vjetëve, të dashurit e mi janë harxhuar para për nja 5 apo 6 Ministri Kulturë. Njëherë është bërë këtu, njëherë atje dhe nuk më dha 5 lekë për lapidarin e Spahivoglit. Nuk m'i dha. Tiranës i takon të ketë një teatër serioz dramatik.


Mua, sa herë të keni mbledhje të tilla, do të më thërrisni, sepse jam i gatshëm të vij. Punën e ligjit nuk e di fort mirë, por dua të them që kemi aktorë të mrekullueshëm që unë i ndjek, i shoh. I kemi shumë të mirë dhe paguhen për një çapë bukë, për një kafshatë bukë. Kur të vënë në fyt litarin e bukës, ai është më i tmerrshmi nga të gjithë.

MIRUSH KABASHI, AKTOR: MË KOMUNIZËM KISHIM NË SHUMË LIRI

Ligji ekzistues është autoritar. Drejtoret artistikë i cakton kryeministri, bordin artistik e zgjedh ministri dhe komuniteti artistik të çuarit atje dikujt me mandat. Këtu po demitizohet dhe liderëve të komunitetit tonë,



nuk ka asnjë lloj të drejte për të zgjedhur. Skema është e gatshme. Si tek futbollit, edhe shkollat, ky duhet të jetë sistemi ynë, që ne të kemi mundësi të zgjedhim bordet artistike, mbi bazat e konkurseve dhe me votim. Nuk po flas për drejtoret, por këshilli artistik i tan-



Robert Ndrenika dje para mediave

ishëm në TK nuk ka asnjë aktor, asnjë regjisor, asnjë dramaturg. Ky ligj që ne kemi është më autokratik se në kohën e Ramiz Alisë. Berti e kujton kohën kur u bë një ligj për teatrin, që ua hiqte të drejtën komiteteve të partive që të merren me problemet artistike dhe me probleme të repertorit të teatrit. Këtë të drejtë ua delegoi këshillave artistikë, që zgjidheshin nga kolektivit. Kjo zgjat për një apo dy vjet. Imagjinoni, edhe atëherë ne kishim guxim të ngrinin zërin kundër një vendimi të Komitetit Qendror, kurse sot është kthyer mbrapsht. Është kryeministri që cakton drejtorin artistik, me propozim të ministrit të Kulturës. Sigurisht që ata do kenë menaxherët, supervisorët e tyre nga ana financiare, pasi paratë e biletave nuk e mbajnë teatrin, por kjo piramidë artistike është e turpshme. Drejtoret i shkrujnë sindikatat dhe kjo erdhi që nga kryeministri, i cili tha që tek ne nuk ka sindikata. Unë kam pasur fatin e keq që të jem në krye të sindikatës së Durrësit që në vitin 1990 dhe ta mbyll në TK. Dhe kemi punuar shumë për dy probleme, për ligjin dhe për statusin. Dhe ky i fundit është i gatshëm. Nuk dua të merrem me pikë-pamjet tuaja politike, por në momentin që bëheni zëdhënës të politikës, i keni hyrë në hak profesionit tuaj. Rrini larg politikës! Ku e hidhni votën është punë për ju, por jeni shumë më lart se politika. Ne duhet ta shohim nga lart poshtë politikën. Rrini të bashkuar, mbani traditën e një zanati, që populli e do shumë.

GENCI FUGA, AKTOR: PROBLEMI ËSHTË MINISTRJA

Në konceptin tim, të dyja çështjet mblidhen në një emër, që është ministrja e Kulturës. E para, është një çështje teknike. Lëvizja e dikujt nga institucioni, pa mandat, edhe të çuarit atje dikujt me mandat. Këtu po demitizohet dhe liderëve të komunitetit tonë,



Ndrenika: I kam thënë dhe ministreshës për teatrin... Aktorët paguhen për një çapë bukë dhe u vënë litarin në fyt.



Artistët dhe në takim

për të shtrirë në rast se prishet teatri. Pra, jemi në situatën që na ka ikur vendi ku të shtrihemi. Edhe këtë projektligj e shikoj shumë pranë firmosjes nga kryetari i Parlamentit, edhe fatkeqsisht nëse merr trajtën e një ligji, sepse në fakt nuk është ligj, është organizim i brendshëm i ministrisë, që i shkoj deri në fund projektligjit. Duhet të gjejmë format "atraktive" për të arritur që kjo situatë të ndryshojë, në të kundërt do të merremi përsëri me shashkën e radhës. Të mendojmë të gjithë në formën e protestës tashmë, se jemi të gjithë krijues edhe interpretë, që të arrijmë aty ku duhet.

ARBEN DERHEMI, AKTOR: NA MBAJNË PËR BUKËN E GOJËS

Po ikën shtëpia jonë dhe në rast se nuk reagojmë tani, nuk do të reagojmë kurrë më, sepse nuk do të kemi shtëpi për të reaguuar. Të gjithë bashkë, nuk ka rëndësi se çfarë dëshirash edhe ngjyrash kemi, por duhet që të dalim në protestë të gjithë se në një moment të caktuar që një njeri merr përsipër të thotë që do të vijë TKOB në TK dhe TK do të shkojë te "Turbinë", tek një teatër, që nuk është teatër, por një pallat lojërash me dorë. Është një çudi e madhe. Por, përse duhet që të ndodhë që një institucion të



vijë në një institucion tjetër, edhe në atë ku është TK të vijë një tjetër edhe TK mbas pesë vitesh, që ka ikur që këtej, të vijë për godinën e re, që do jetë marramendëse edhe fantastike, por që nuk dihet se si është derisa nuk ka asnjë projekt. Nuk ka asnjë projekt. Është thjesht motiv për të përzënë TK nga ajo godinë ku është. Para 25 vitesh na thanë njëherë që do të bjerë TK. Nuk ra TK në 20 vite. Pas mosrënies në TK për 20 vite, na thanë që nuk është më një teatër, që mundet të vijë spektrotërit etj. Përse duhet që të vijë spektrotërit e operës në TK dhe spektrotërit e TK-së të shkojnë edhe të ngrihen tek teatri "Turbinë". Këtë nuk e konceptoj dot. Mund të jetë edhe logjikë regjisoriale, që e ka marrë nga familja. Në emër të të gjithë aktorëve të TK, disave, se ka edhe nga ata që nuk merren me demonstrata, do të flasim dhe të dalim para Kryeministrit, që po tallen me ne. Na kanë lënë për një copë bukë, kemi një problem shumë të madh, sepse në 5 vite nuk kanë bërë asgjë. Nuk kanë bërë një status për ne. Për çdo lloj aktori, jo vetëm në TK. Ne jemi kategoria më inferiore që mund të ekzistojë në administratën e shtetit shqiptar. Kemi kontrata 1-vjeçare. A e kuptoni këtë? Kontratë 1-vjeçare do të thotë, që të të mbajë varur, që t'i të mos të flasësh, se ndryshe unë ta heq kontratën. Na u tha që do të merren shpërblime të figurës artistike, u trumbetua, erdhën drejtoret me këtë ide, se njerëzit do të marrin shpërblime, por nuk ndodhi. Thanë që nuk ka një çyckël në ligj, që të bëjë që ju të merrni shpërblimet. Ministria të diskutonte me

ne, me grupet e interesit. Jo vetëm nuk e bëri këtë, por vjen puna që na nxjerr edhe një projektligj të çuditshëm. Jam i mendimit që të gjithë kështu si jemi, sepse TK është i të gjithëve, jo vetëm i yni, duke nisur nga studentët e UA-së, e duke përfunduar tek ai më i vjetri i kësaj pune, tek Robert Ndrenika-të jemi më të fortë se sa dukemi, të jemi akoma më të fortë, të dalim para ministrisë, të kërkojmë të drejtën tonë për të ndënuar në atë institucion që është i yni, për t'u mbyllur në atë institucion, që është bërë foro artistike nga e gjithë Tirana. Është bërë pedonale. Sepse edhe pedonale ka një motiv, përse është bërë pedonale. Është bërë pedonale për motivin e vetëm, që të kuptohet se TK nuk ekziston, nuk ka oborr. Ne duhet që të ballafaqohemi me këtë zonjë me flokë të gjata edhe me mendtë të shkurtra, që të kuptojmë se çfarë ndodh. A e ka nga padituria, apo nga keqdashja? Nuk gënjenhem 700 burra dhe gra.

MEHDI MALKAJ, AKTOR: NUK JEMI SKLEVËR

Unë ngul këmbë në një gjë. Ne vetë duhet të kuptojmë se nuk jemi sklevër. Ata na trajtojnë si sklevër. Nguleni në kokë këtë, ne nuk jemi sklevër. Ne jemi vlerë kombëtare. Ata na marrin edhe na nxjerrin përjashta. Përse? Se nuk kemi gojë, se nuk kemi personalitet.

NERITAN LIÇAJ: JEMI SI NË KOHËN E ENVERIT

Kemi përballë një qeveri, jo vetëm një ministër arrogante, të cilët nuk pranojnë biseda. Çfarë du-

MALKAJ

Ata na trajtojnë si sklevër. Nguleni në kokë këtë, ne nuk jemi sklevër. Ne jemi vlerë kombëtare. Ata na marrin edhe na nxjerrin përjashta. Përse? Se nuk kemi gojë, se nuk kemi personalitet.

het të bëjmë? Duhet të ngremë zërin nëpërmjet protestave, nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha institucioneve, parlament, Kryeministri, Presidencë, të ftojme shoqërinë civile dhe të ngremë një valë të madhe kundër kësaj arrogancë. Ligji është totalisht i papranueshëm. Kemi të bëjmë me njerëz që kanë ardhur për të na shkatërruar, që ta kthejmë gjithçka në kontroll. Gjithçka si në kohën e Enverit, që centralizohen gjërat vetëm në një dorë. Në radhë të parë për nga pikëpamja artistike, në radhë të dytë është një dëm i madh kombëtar, sepse bëhet fjalë për teatrin si fenomen, jo vetëm për TK ku jemi ne. Prandaj nëse do të duam që t'i ulim në tavolinë edhe të negociojmë, duhet të rrisim presionin. Presioni duhet që të jetë i madh, sepse ne e dimë se si funksionojnë qeveritë shqiptare. Funksionojnë me mentalitet kriminal. Do të fusin përçarje, intimidime etj. Betejë duhet që t'i shkojmë deri

në fund, sepse i kemi të gjithë me vete. Të ngremë një valë të madhe, ne që merremi me art, dhe të përfshijmë të gjitha institucionet e tjera të artit dhe kulturës, që vuanë të njëjtat problematika, në mënyrë që të zgjidhim çështjen. Nuk ka kohë për stërzgjatje.

TAULANTA JUPI, REGJISORE: NGRINI ZËRIN

Bashkohem me të dyja pikat. Përqendrohem me shumë forcë tek ato që duhet të bëjmë. Ministria e Kulturës dhe kjo qeveri me këtë ligj që duan të na përfshijnë dhe të aprovojnë na kanë shpallur luftë. Arti nuk i fundit, sepse unë nuk kam ndërmend që ta kem mirë me zonjën ministre, që të bëjë një projekt teatror. Unë dua që ta kem mirë me ligjin, unë dua që të kem një ligj që të mbroj të drejtat e mia, si artiste, qytetare edhe intelektuale. Kemi arritur në një pikë, që themi se nuk duhet që të ngremë zërin, nuk duhet të ngremë zërin, nuk duhet të ngremë zërin. Mjaftojnë 27 vite të dashurit e mi për të mos e ngritur zërin. A nuk ka ardhur ky moment për të mos e ngritur zërin. Nuk është puna që të dalim te Kryeministria, por jam e meditim-it që të shkojmë edhe të zëmë derën e ministrisë. Kjo e zgjidh. Ajo nuk duhet të futet më në zyrë pa negociuar me ne.

ROMIR ZALLA, AKTOR: NA SHOHIN SI PABUKSA

Problemi është që ligji ka një frymë centralizimi, që duhet luftuar sepse nëse zgjidhet kjo, çdo gjë arrihet. Përtej faktit që është mbushur kupa e duhet që të shpërthejmë, mendoj se duhet që të mbledhim të gjitha gjërat që nuk shkojnë dhe të jemi konkretë në gjëra konkrete. Fryma vjen nga mentaliteti që kanë këta zotërinjtë për të bërë diferencime të tipit se opera genka më e rëndësishme, edhe TK mundet që të shkojë edhe të diga, se nuk ka asnjë problem. Apo gjëra të tipit, që TK i shkrihet qendra e artit, apo edhe qendra e filmit që është duhet që të shkrihet, sepse duan që ta kenë nën hyqem, që të bëjnë çfarë të duan, edhe të na konsiderojnë pabukësia, që jemi të varur pas cikërrimave dhe pikatoreve që hedhin ata zotërinj. Ne duhet që të kërkojmë disa pika. Të shpallim edhe një grevë, në kuptimin që mos të ketë asnjë shtaqje, pavarësisht se është krijuar përshtypja që ky popull rron edhe pa teatër, edhe pa film. Unë nëse do të isha, do të shpallja grevë totale. Ne nuk bëjmë asnjë lloj aktiviteti, nëse gjërat nuk vihen në vendin e vet.

LAERT VASILLI, AKTOR: BOJKOT PUNËS

Propozohet në projektligj një drejtim vertikal, që fillon me një centralizim nga kreu deri në fund, apo ajo që ne dëshirojmë është një vetëqeverisje apo një vetëvendosje, që fondi të shpërndahet siç duam ne artistët dhe siç na takon. Jo një shpërndarje që të vijë nga kreu edhe të shpërndahet në bazë. Duhet të vijë me marrim pjesë në aktivitet, le të rrezikojmë vendin e punës, të na pritet buka e gojës, edhe për ju që jeni familjarë t'u hiqet edhe ushqimi i fëmijëve. Nëse nuk rrezikojmë

ne, një ditë do të ngrihem, dhe muri që është ngritur dhe përballë nesh do të shikojmë një gradacelë, që nuk mundet që ta shembim dot. Pra, a bëhet fjalë për një vetëqeverisje tonën apo për një urdhër vjen nga lart edhe fondet shpërndahen ashtu siç mendojnë drejtorët, që janë tani në projekte, që e shohim çdo vit. Le të mos bëjmë këtu sikur takohemi për herë të parë, se e dimë shumë mirë se si merren projektet dhe shfaqjet që bëhen me dyer të mbyllura, sa për fotografi dhe çohen në MK, si projekte vetëm për të justifikuar fondin. E dimë shumë mirë se si mjeshtrit e bordit, thonë: 'Do të luaj unë këtu, që të marrësh ti projektin'. Ose 'do të hedhësh zarfin lalë, ndryshe nuk ka film'.

ALTN BASHA, REGJISOR: VRASJE TË PLURALIZMIT KULTUROR

Kjo çështje ka filluar që para 5 vjetësh, kur u mbyll Qendra e Artit, që ishte një akt shumë i rëndësishëm kundër zhvillimeve në kulturë, sepse ajo ishte një lloj qeverisjeje e artistëve, më pas u mbyll festivali i të rinjve, që u hoqi të gjithë të rinjë të aplikonin për një projekt. Të gjitha këto janë në emër të abuzimeve. Po të ecnim me këtë logjikë, duhet të ishin mbyllur



gjihta ministrtritëri Shqipëri për shkak të abuzimeve. Sa i t a k o n "Turbinës", nuk u konsultua fare me komunitetin. Ditën e prezantimit të projektit u kuptua që as drejtuesit e institucioneve dhe askush tjetër nuk ishte konsultuar për këtë çështje. Për të ardhur deri tek ligji... Unë këtë e shoh si vrasje të pluralizmit kulturor. Për mua kjo është si të vendosësh bustin e Enver Hoxhës në mes të Tiranës. Kjo është ajo që po ndodh. E centralizon në mënyrë përfundimtare dhe eliminon çdo lloj mundësi për zhvillim kulturor të pavarur në këtë vend. Çështja e TK është një problem absurd. Nëse do të ndërtohet një teatër i ri, duhet të njohim projektin. Nëse në godinën ekzistuese hyn opera, do të thotë që ajo ndërtesë është funksionale. Ato 4 milionë euro që janë hedhur tek Piramida mund të ishin përdorur për Teatrin Kombëtar. Madje, nuk është e vështirë edhe të rikonstruktoret ai. Nuk është edhe aq dramatike, të mos na bëjnë për budallenj. Sa i takon ligjit, ai duhet rishikuar. Problemi nuk është vetëm te Teatri Kombëtar: Në një kohë që duhet të ndërtojmë institucione të reja, kalojmë tek bazika: do kemi apo nuk do kemi teatër? Kjo është dramatike. "Turbinë" meqë është ndërtaur, të funksionojë si skenë e pavarur, pasi kemi alternativa teatore pa fund. Kemi regjisorë të rinj dhe aktorë që nuk janë të përfshirë në TK. Meqë është bërë investimi, pasi edhe si skenë alternative ajo ka probleme të mëdha. Është si pallat sporti. Le të shkojnë artistët erinjtaje, por ama të spostohet TK, nuk ka asnjë kuptim. Së pari, duhet të kuptojmë nëse ka gatishmëri për dialog, edhe pse në një mendim se nuk ka, pasi e kemi provuar 5 vjet me radhë. Është bërë vetëm një takim kur ministria ka marrë mandatin, asnjë tjetër. Nëse nuk ka dialog, do të provojmë forma të tjera.

Opinion i Ditës

Vetizolim apo lënie anash nga BE-ja?

Nga Arton Konushevi

Opozita po i bën fajtorë qeverinë dhe liderët e institucioneve të Kosovës, se me veprimet e tyre po e vënë në dyshim orientimin strategjik të vendit për të ardhmen euroatlantike.

Fajësimi i Bashkimit Evropian, nga krerët e institucioneve për izolimin dhe lënien anash të Kosovës nga procesi i liberalizimit të vizave si dhe mungesa e një perspektive të qartë integruese me strategjinë e fundit, po komentohen në mënyra të ndryshme nga opozitarët dhe përfaqësuesit e partive në pushtet. Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Vjosa Osmani thotë se ishin veprimet e fundit të liderëve politikë, me të cilët u ndikua që Kosova të bëjë hapa prapa drejt Bashkimit Evropian.

"Liderët politikë që sot janë në pushtet, u kanë dhënë shumë arsye vendeve të BE-së, përfshirë edhe atyre që na kanë njohur, të mendojnë se Kosova nuk meriton përkrahjen e tyre, as në kontekstin bilateral e as në organizma multilateral, siç është BE-ja".

"Kjo tregon jo vetëm qasjen e gabuar që ata kanë rreth integritet evropian, por edhe mungesën e përgjegjësisë në një proces në të cilin më së shumti i pasojat i bartin qytetarët e Kosovës", tha Osmani.

Osmani tha, po ashtu, se parësishisht faktit që rruga e Kosovës drejt Bashkimit Evropian është e formalizuar, Strategjia e zgjerimit e publikuar nga Komisioni Evropian, konfirmon se reformat që duhet të ndërmerren duhet të jenë të shpejta dhe të prekshme, por të cilat aktualisht i mungojnë vendit.

"Kjo qeveri fatkeqësisht që në ditët e para ka dëshmuar se nuk ka as vizion e as njohuri sesi të bëhet kjo. Prandaj, sa më parë që të largohet, aq më shpejt qytetarët e Kosovës do të ecin drejt integritetit", -u shpreh ajo.

Ndërkaq, deputetja Shqipe Pantina nga Lëvizja Vetëvendosje, po ashtu parti opozitare në Kuvend, tha se liderët politikë para se të fajësojnë Bashkimin Evropian se pse Kosova është lënë kaq larg BE-së, duhet të bëjnë një vlerësim se çka është bërë dhe çka nuk është bërë nga institucionet, për t'u përafuar me BE-në.

"Natyrishisht se përgjegjësia kryesore bie mbi institucionet tona dhe njerëzit që kanë drejtuar këto institucione, sidomos në dekadën e fundit. Kjo nuk do koment, sepse shumë nga detyrat që duhet të kryhen janë përgjegjësi e institucioneve tona. Sundimi i ligjit, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, krijimi i një tregu



konkurrues, nuk janë vetëm çështje, të cilat ne duhet t'i përbushim si kriter apo kushtet e vëna nga BE-ja. Këto janë çështje, të cilat çdo shtet normal duhet t'i plotësojë për të rritur mirëqenien e qytetarëve", -tha Pantina për Radion Evropa e Lirë.

Në anën tjetër, deputetja Osmani tha se liderët politikë duhet t'i lexojnë mirë kërkesat e BE-së, ku potencohet qartë se kërkohen rezultate të prek-

Një ditë pas publikimit të Strategjisë së re të zgjerimit nga Komisioni Evropian, ishte presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ai i cili kishte kritikuar Bashkimin Evropian, duke vlerësuar se BE-ja ka dështuar që ta adresojë qartë perspektivën integruese të Kosovës. "Kjo qasje jo e drejtë ndaj Kosovës është pasojë e mosnjohjes nga pesë shtete anëtare të BE-së, respektivisht e paaftësisë së BE-së për një qëndrim unik për Kosovën", -kishte vlerësuar Thaçi.

shme në sundimin e ligjit.

Derisa në raportet e Bashkimit Evropian thuhet se "Kosova është shtet i kapur", kjo sipas saj, tregon se nuk mund të shihet qartësi drejt integritet evropian.

"Logjika që liderët aktual shtetërorë po e përdorin, duke fajësuar për gjithçka Bashkimin Evropian dhe duke injoruar detyrat e shtëpisë, të cilat janë të përcaktuara ndër vite me radhë për Kosovën, është vetëm logjikë e gabuar dhe logjikë, e cila e bën Kosovën që të bëjë hapa prapa", -tha Osmani.

Një ditë pas publikimit të Strategjisë së re të zgjerimit nga Komisioni Evropian, ishte presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ai i cili kishte kritikuar Bashkimin Evropian, duke vlerësuar se BE-ja ka dështuar që ta adresojë qartë perspektivën integruese të Kosovës.

"Kjo qasje jo e drejtë ndaj Kosovës është pasojë e mosnjohjes nga pesë shtete anëtare të BE-së, respektivisht e paaftësisë së BE-së për një qëndrim unik për Kosovën", -kishte vlerësuar Thaçi.

Ndërkohë, ministrja e Integritet Evropian në Qeverinë e Kosovës, Dhurata Hoxha ka theksuar se Kosova ka pritur më shumë dhe hapa më konkret në Strategjinë e re të Bashkimit Evropian për Ballkanin. Megjithatë, siç ka thënë ajo, Kosovës i mbetet të përfundojë detyrat dhe obligimet, në mënyrë që të ecë me hapa të shpejtë drejt BE-së.

Në anën tjetër, edhe deputetja opozitare Shqipe Pantina mendon se si Kosova, ashtu edhe BE-ja, nuk kanë një koordinim të duhur.

"Këtu ka faj edhe vetë Bashkimi Evropian, sepse ka pasur kompetenca të zgjeruara në fushat për të cilat më së shumti kritikohet Kosova edhe në këtë Strategji, por edhe në Raportet e mëhershme të Progressit nga BE-ja", -tha Pantina.

Strategjia e re e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor e publikuar më 6 shkurt, ka parashikuar afate kohore vetëm për Serbinë dhe Malin e Zi, sipas së cilës, këto dy vende mund të anëtarësohen në BE diku në vitin 2025.

Përdërisa vendet tjera si Shqipëria, Maqedonia, Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova janë përfshirë në Strategjinë e Zgjerimit, por pa ndonjë afat kohor për anëtarësim.

Krahas angazhimeve për zbatimin e kriterëve evropian për anëtarësim në Bashkimin Evropian gjatë viteve të ardhshme, Kosova është vonuar për gati tri vjet me plotësimin e kriterit të kërkuar nga BE-ja për liberalizimin e vizave, që ka të bëjë me ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi.

Opinioni i Ditës

Dështim i paparë i BE në Kosovë e Bosnjë

"Deutsche Welle"

(vijon nga faqja 1)

.... Perëndimor merr miliarda nga BE" nënvizon se strategjia e re për Ballkanin jep një plan të qartë kohor dhe do t'i kushtojë shumë shtrënjtë unionit. "Komisioni propozon rritjen e ndihmave të anëtarësimit dhe të përfarimit me BE deri në vitin 2020. E paqartë mbetet se për çfarë shumash bëhet fjalë. Deri më tani ish-in planifikuar për Ballkanin Perëndimor nga viti 2018-2020 1,7 miliardë euro. Në dokumentin strategjik bëhet fjalë se 1,07 miliardë janë në plan vetëm për vitin 2018, kështu që tani mbetet vetëm të rriten shumat e 600 milionë eurove të mbetura për vitin 2019 dhe 2020".

'FAZ' sheh me sy kritik paratë që BE derdh në Ballkan. "Ka shumë para derdhen në Ballkanin Perëndimor për forcimin e administratës, shtetit ligjor, ekonomisë së qëndrueshme dhe demokracisë e mirëqeverisjes. Por janë pikërisht këto fusha, ku Komisioni shikon deficitet më të mëdha, me gjithë ndihmat miliardëshe prej vitesh".

Ndërsa gazeta gjermane "Tagesszeitung" i kushton vëmendje perspektivës më të qartë kohore të integritit të Serbisë në BE. 'TAZ' thekson se Brukseli dhe Berlino mendojnë se Serbia është një faktor stabiliteti në Ballkan, por e kundërta është e vërtetë. "Serbia dhe Mali i Zi do të mund të pranohen në vitin 2025. Po pse pikërisht vendet ku fjalën e kanë BE dhe institucionet ndërkombëtare janë të fundit në radhë? Në Kosovë dhe në Bosnje ka një administratë ndërkombëtare, polici ndërkombëtare, misionet e shtetit ligjor, trupa ndërkombëtare. Pikërisht që këto shtete janë të fundit në radhë dhe kosovarët ende duhet të marrin vizë për në BE, është një dështim i paparë".

"TAZ" nënvizon se luftën kundër korrupsionit nuk e ka fituar njeri dhe se të rinjtë shkolluar largohen nga Ballkani për të ndërtuar një jetë të re në Gjermani, Austri, vendet skandinave dhe shtron pyetjen se "pse nderon kancelarja Merkel njeriun e fortë të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, që e ka kthyer Serbinë në një 'demokratë', që refuzon përballjen me krimet e përgjakshme të viteve '90-të'?" "Me sa duket, ende ekziston përfytyrimi i gabuar se Serbia është një faktor stabiliteti në Ballkan. Por nga



koha e Millosheviçit në vitin 1991 duhej të dihej ndërkohë, se e kundërta është e vërtetë. Serbia nuk ka hequr dorë nga rifitimi i Kosovës dhe ndarjen e Bosnje-Hercegovinës përgjatë linjës së frontit të vitit 1995...".

Ndërsa gazeta zvicerane, nën titullin "Sherifë të rinj për veriun

e egër të Kosovës" nënvizon se në pjesën serbishtfolëse të vendit, Beogradi i ka vënë nën kontroll politikanët dhe përdor për këtë partner të dyshimtë. "Presidenti Vuçiq është i vendosur për procesin e normalizimit dhe ta dorëzojë këtë rajon në sistemin kosovar. Por kjo nuk do të thotë fund të influ-

encës serbe, përkundrazi. Përmasë partisë së unitetit të kontrolluar nga Beogradi, ai i kontrollon të gjitha rajonet me serbë. Në vend që të mbeten të varur nga shteti serb, subvencionimi do të bëhet në bazë të së drejtës kosovare përmes asociacionit të komunave serbe, të cilin e financon Beogradi".

HOROSKOPI

DASHI
Hëna nuk shkon mirë me Plutonin në qiellin tuaj dhe atmosferën që jetoni me atë që ju ka hyrë në zemër. Pakënaqësia prirret të mbizotërojë. Mos e vini në dyshim atë që ndjeni për partnerin që në zënkat e para që keni me të.

DEMI
Jeni përballë një zgjedhjeje të rëndësishme. qëndrojuini zgjedhjeve të bëra më parë dhe mos hiqni dorë nga autonomia juaj. Mos i lejoju një familjari t'ju pengojë. Do t'ia dilni të angazhoni në nisimat tuaja, duke prekur pikat e dhura emocionale.

BINJAKET
Marsi dhe Venusi ju mbështesin. Dashuria do të vazhdojë të ketë një rol shumë të rëndësishëm në jetën dhe mendimet tuaja. Do të përjetoni edhe anë e mëmbia. Një vizitë e juaja, edhe pse e shkurtrë, do të gëzojë një familjar apo një të afërm. Do të ndihni të kënaqur.

GAFORJA
Keni nevojë të kaloni çaste të qeta. Largoni me takt persona që nuk janë shumë pozitive, të cilët ju marrin nëpër këmbë dhe buzëqeshini jetës. Hëna bën që të provoni të zgjidhni një problem midis miqve, por nuk do ta keni të thjeshtë.

LUANI
Me Uranin, Saturnin dhe Plutonin bashkëpunëtorë, perspektivat sentimentale janë të mira. Mund të nisni një histori pasioni, e cila mund të kthehet në një lidhje të qëndrueshme. Ndoshta në dashuri nuk jeni ende gati për të ndërruar hapin madhor, por me siguri drejt asaj rrugë jeni.

VIRGJERESHA
Përfaqësimi i Uranit kundra, nuk është rasti për të bërë betejë kundër mullinjve të erez. Prandaj mos e çoni ndër mend se mund të ndryshoni botën! Si zakonisht, mbi të gjitha për çështje pune, reagoni duke u mbështetur mbi vendosmërinë dhe saktësinë.

PESHORJA
Sot jvet nuk janë shumë të shkëlqyeshme. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat do të dalin se nuk janë problematike! Në punë mos bini shumë në sy, rritni të qetë dhe shfaquni aftësitë që keni në momentin e duhur.

AKREPI
Në familje do të keni disa kundërshime të shkaktuara nga këndvështrime të ndryshme. Mos u merrisni, larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni kolegët që ju rritni pranë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

SHIGJETARI
Për meritë të pozicionimit të Saturnit në lidhje me Hënë dhe Diellin, do të përballeni me shpirtin e përshatjes një ndryshim të papritur programi. Me një shtytje të mirë do të jetësoni projektet që keni duke tejkulluar pengesat.

BRICJAPI
Nën mbikëqyrjen e Plutonit, ditën e sotme do të vihet në pah ana më kokëfortë e karakterit tuaj. Mbaje mend të rikthehen zënka të vjetra familjare. Nxitimi mund të bëjë që të bëni gabime, prandaj përpara se të veproni, mendojeni mirë atë që do të bëni.

UJORI
Keni arsyet më të mira për të ndihmuar një familjar që të tejkalojë vështirësitë dhe pasiguritë. Në këmbim do të merrni shumë mirënjohje të sinqertë. Me Jupiterin në shenjë, do ta keni rrugën e hapur për të pasur veprimtari kulturore.

PESHQIT
Përpiguni të mos të keni besim të pakufshëm të burimet tuaja dhe mundohuni të jeni më objektiv, nëse nuk doni që të përballeni me zhgënjime. Kujdesuni për shëndetin! Bëni veprimtari fizike dhe shëtitje në natyrë, edhe pse është një stinë e ftohtë.

DORËHEQJA



Rob Porter

Akuzat e dy ish-bashkëshorteve e fundosin, jep dorëheqjen këshilltari i Trump.

Një nga këshilltarët e Presidentit amerikan Donald Trump ka dhënë dorëheqjen dje pas akuzave për abuzim nga dy ish-bashkëshortet e tij. Sekretari i stafit të Shtëpisë së Bardhë, Rob Porter tha se këto akuzat shokuese janë të pavërteta ndërsa njoftoi

dorëheqjen e tij. Akuzat nga ish -bashkëshortet e Rob Porter në fillim u raportuan nga e përditshmja britanike 'Daily Mail' dhe përfshijnë eksperiencën abuzimi fizik dhe emocional. Ish-gruaja e tij e parë Colbie Holderness tha se këshilltari i Shtëpisë së Bardhë kishte

qenë verbalisht dhe fizikisht abuziv, ndërsa përmendi disa raste ku ish- bashkëshorti e kishte goditur në fytyrë gjatë kohës që kishin qenë të martuar. Ndërkohë ish-bashkëshortja e tij e dytë Jennifer Willoughby, e cila ishte e martuar me Porter për katër vite, tha se kishte

kërkuar një urdhër mbrojtje ndaj tij në qershor të 2010. "Daily Mail", gjithashtu, raportoi se Rob Porter nuk e kaloi testin e sigurisë për postin e tij në Shtëpinë e Bardhë pasi Byroja Federale e Hetimit intervistoi dy ish-bashkëshortet e tij. Sakaq Shtëpia e Bardhë nuk ka komentuar akoma mbi raportimet se Rob Porter nuk e kaluar testin e sigurisë nga FBI.

Vizita e zyrtarit të lartë evropian në Serbi një ditë pas publikimit të strategjisë së zgjerimit

Hahn: Marrëveshja Beograd-Prishtinë, letër e zbrazët

Pamela Aliaj

Komisioneri për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn ka zhvilluar një konferencë mbi perspektivën e Beogradit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Megjithatë, theksi i zyrarëve evropian në Beograd vendoset gjithmonë të marrëdhëniet që mban shteti serb me Kosovën. Në konferencën ku u fol për perspektivën e integritetit të Serbisë në Bashkimin Evropian, Hahn u shpreh i pakënaqur për marrëdhëniet që janë mes Beogradit dhe Prishtinës. Komisioneri e bëri të qartë se blloku nuk do të importojë konflikte të pazgjidhura. "Marrëveshja ligjërisht e detyrueshme midis Serbisë dhe Kosovës është aktualisht në letër e zbrazët", deklaroi në Beograd Komisioneri për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn. Në konferencën "Strategjia për Ballkanin Perëndimor, hapja e rrugës për anëtarësim në BE", Hahn tha se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve, miratimin e së cilës BE-ja e kërkon para anëtarësimit të Serbisë në bllok - varet nga rrjedha e dialogut. "Kjo marrëveshje është tani për tani një copë letre e bardhë. Nuk dua të paragjykoj, por është e rëndësishme që dy palët të gjejnë zgjidhje që çojnë direkt nga dokumenti i detyrueshëm që ne e kërkojmë", theksoi Hahn, ndërsa një mesazh i përçoi edhe Kosovës. "Duhet të shihet si një motiv edhe për Kosovën që të punojë me Serbinë në një dokument ligjërisht detyrues dhe të normalizojë marrëdhëniet", tha Hahn. Ndërsa e zyrarit të lartë evropian në kryeqytetin serb erdhi një ditë pas publikimit të strategjisë së zgjerimit, që parashikon vitin 2025 si afat për adrimin e Serbisë dhe Malit

Komisioneri për zgjerim: Forconi dialogun, ndryshe s'ka BE

të Zi, nëse përbushin reformat dhe kriteret e nevojshme. Një fjalë ka mbajtur edhe presidenti serb, Aleksandër Vuçiç. Vuçiç foli për "male të tëra me pengesa" në negociatat e vendit të tij me Brukselin, duke e vënë theksin te çështja e Kosovës, por edhe kufijve në Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci. Megjithatë, lartësitë e maleve me pengesa nuk e penguan presidentin serb të shpreh vullnet të qartë të shtetit serb që t'i japë zgjidhje një herë e mirë problemeve dhe ndasive të



Komisioneri për zgjerim Johannes Hahn dhe Presidenti Serb Vuçiç

Beogradit me vendet fqinje. Në praninë e zyrarit të Brukselit, presidenti serb foli për vendime të mëdha dhe serioze. "A janë pengesa të lehta? Nuk janë. Si Himalajet janë, por nuk do të ishim të parët që janë ngjitur në malin Everest. Detyrat më të rënda që dalin nga strategjia e Komisionit Evropian janë për Serbinë dhe ka ardhur koha që 'të merren vendime, të paguhen çmime të caktuara nga e kaluara' dhe të zgjidhim probleme që nuk janë zgjidhur dekada më parë", tha Vuçiç. Presidenti serb Vuçiç shtoi se për çështje të tilla serioze duhet dëgjuar edhe zëri i qytetarëve, vendimi i të cilëve do të respektohet. "Këtë do ta vendosin qytetarët dhe ne do ta respektojmë atë vendim. Por, nuk do të fshihem, do ta them atë që mendoj se është më e mira për vendin, ndërsa qytetarët do ta vlerësojnë në është e drejtë apo jo", deklaroi Vuçiç. Ndërkohë, shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini dy ditë më parë u shpreh mjaft optimiste lidhur me dialogun e vendosur mes Kosovës dhe Serbisë. "Në muajt e fundit unë shoh vendosmëri nga Beogradi dhe Prishtinë për të diskutuar normalizimin gjithëpërfshirës, me shpresë që do të reflektohet në një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme. Unë besoj që një marrëveshje mund të arrihet deri në fund të vitit 2019", ka thënë dy ditë më parë Federica Mogherini, e cila ka ndërmjetësuar disa takimeve mes liderëve të Kosovës dhe Serbisë.

Hoxhaj në Strasburg: Strategjia e re e BE detyron Serbinë ta njohë Kosovën




Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver

Kosova nuk merr liberalizimin pasi që t'i kryej detyrat e saj brenda vitit 2018, këtij dialogu do t'i humbasë kuptimi, dhe atë jo vetëm në planin politik, por edhe atë të mbështetjes së qytetarëve", ka theksuar Hoxhaj. Zëv-

endëskryeministri Hoxhaj ka takuar kryetarin e Komitetit për Politikë të Jashtme (AFET), David McAllister, eurodeputetin Tania Fajon si dhe eurodeputetin sllovak Eduard Kukan. U kam kërkuar mbështetje në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, pasi që një gjë e tillë nënkupton integrimin individual të çdo qytetari të Kosovës në Bashkimin Evropian, dhe është e drejtë fundamentale e qytetarëve të lëvizin lirshëm në Evropë", ka thënë Hoxhaj. Hoxhaj ka zhvilluar takim edhe me Presidentin e Komisionit të Venecias, Gianni Buquicchio dhe sekretarin e Përgjithshëm të këtij Komisioni, me të cilët kanë diskutuar për bashkëpunimin e Kosovës me këtë komision.

të Jashtme në Parlamentin Evropian, David McAllister, eurodeputetin Tania Fajon si dhe eurodeputetin sllovak Eduard Kukan. U kam kërkuar mbështetje në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, pasi që një gjë e tillë nënkupton integrimin individual të çdo qytetari të Kosovës në Bashkimin Evropian, dhe është e drejtë fundamentale e qytetarëve të lëvizin lirshëm në Evropë", ka thënë Hoxhaj. Hoxhaj ka zhvilluar takim edhe me Presidentin e Komisionit të Venecias, Gianni Buquicchio dhe sekretarin e Përgjithshëm të këtij Komisioni, me të cilët kanë diskutuar për bashkëpunimin e Kosovës me këtë komision.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Një është edhe tatami.
6. Eshhtë raketa europiane.
12. Mund të jetë kokosi.
13. Fillojnë teoremat.
14. Fernando, bomber spanjol.
15. Kufizojnë rastet.
16. Një i tretë në vit.
18. Ente Rajonale Civile.
19. Bëhen duke ndjekur.
22. Në fillin të valles.
23. Të fundit në dyqan.
25. Franchi në stadiumin e Fiorentina-s.
26. Perignon i champagne-s.
27. Një pjesë e nomenklaturës.
29. Një detyrim... mbi xhiro
31. Fund kurrizi
32. Janë edhe ato të fytyrës.
34. Satelit i Uranit.
36. Çela, që qe aktore
37. Ishin xhuxhë të Oberon.

39. Eshhtë bekim... prifti.
40. Janë sportistët në stafetë.
41. Populli i druideve.
42. Fillojnë në bjeshkë.
44. Arte pa re.
45. Një intensive me shumë ilaçe.
47. Neill aktor.
49. Mirella këngëtare lirike.
50. Giorgio i modës.

VERTIKAL

1. Një material për kilt.
2. Një Tatum pianist.
3. Fillojnë praktikën.
4. Diftong teatral.
5. Bien me ballë të tilla.
6. Mbyllin fushatat.
7. Një garë mes cowboys.
8. Inicialet e Reitman regjisor.
9. Gjysma e arenës.
10. Janë ata që nuk janë të qetë

11. Torero i Carmen.
13. Ishin mongolët e Timurlengut.
16. U shkrua nga Camus.
17. Janë bukë si kuleçë.
20. Fillojnë javën.
21. Gjysmë mimize.
24. Përpilojnë akte juridike.
28. Emri i Grameno-s.
30. E famshme Garbo e kinemasë.
33. Brad aktor.
34. Pak afekcion.
35. Vitet pa kufij
36. Thonë se ajo e thyer nuk nuk ngjitet më.
38. Eshhtë gjuhë... e veshit.
40. Eshhtë i pastër në mal.
42. Kingsley aktor.
43. Ruajnë pa ujë.
45. Fillojnë temën
46. Mbyllin një manastir.
47. Në hyrje të sallës.
48. Fund filmi.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë klasik me tutu.
6. Javier, fantazist te Palermo.
12. Thyhet me dy kafshata.
13. Ai dhe ajo.
15. Bo aktore.
16. Terence aktor britanik.
18. Ente Ndërtimi Has.
20. Eshhtë moshë më e bukur.
21. Dhjetë angleze.
22. Në mes të Wolfgan dhe Mozart.
25. Inicialet e Presley.
26. Eshhtë nusja me vello.
27. Eshhtë membranë e syrit.
29. Fund janari.
30. Një metër në sipërfaqe.
31. Bartok kompozitor.
34. Një pjesë e kandidatëve
36. Pak iniciativë.
37. Një pemë.

VERTIKAL


38. Oz shkrimtar izraelit.
41. Fsheh fytyrën.
42. Janë ta lashtë.
46. Me të bëjnë një motor.
47. Qendër ditore.
48. Demoni që persekutonte Sarën.
49. Kush nuk di... mbytet.
51. Një repart veshësh në ambulancë.
53. Shkroi Korbi (imic).
54. Croft e Angelina Jolie.
55. U shkrua mnga Zola.
56. Një lloj kremi.
57. Një pemë.

VERTIKAL


1. Aktori që thirrej Face stone.
2. Eshhtë enë gjaku.
3. Litarët e Tarzanit.
4. Ente Autonoma Mat.
5. Inicialet e Asimov.
6. Ishë babai i Proknet dhe Filomelës.
7. Inicialet e Dall.
8. Kështu i shkon atij që s'i ecën.
9. Pak origjinale.
10. Emri i Descartes.
11. Eshhtë skuadra.
14. I absurdit ai i Samuel Beckett.
17. Të famshme të tilla të Zenonit.
19. Rousseau "Doganien" i pikurës.
23. Bega komik.
24. Diftong në duar.
28. Eshhtë gabi i një pivot.
31. Stoker që shkroi Dracula.
32. Eshhtë byrek.
33. Kapak pa kufij.
35. King Cole i muzikës.
39. Martini që e këngëtare italiane
40. Një lumë i yri.
43. Kukulilla e Ibsen.
44. Bamiri president.
45. Nuk ka tradhtari.
50. Një enë.
52. Kufizojnë lëvizjen.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

M A K U T E R I T I M
A G A R R E N D M I K E
L I T A R E T E S O
E M I L E A P E L I M I
E L E D E P O Z I T A T
A T E K A P A N O N E T
L E S K A N A R I N E A M
E S S E N D A M E A N A
C I P A M I T E E R
M I R K A T E T E L I
K O R R T K U L E O L L A
U N A Z A R E N D O R E

FJALËKRYQI (2)

M I R A N D A B I S H T I
I R A A R M A D H I D
T O A P A R A T E T A E
I N R I M O T E T U M A
I R D A M A R E T I L
I A K O T A N I O D
M K A B I N E T E R A R
P U R T E K E T E N I K E
P E R S E T I N T I M
L A O T G O L L A
I H R T P E T E R I K
V O L E E L E N D E E

SUDOKU

	2			8		3		
			7					2
		4				9		6
	9			2			4	
			1		7			
	1			6			5	
9		6				8		
7					1			
		3		4			2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	2	8	9	6	1	3	7	5
5	3	9	7	4	8	6	2	1
1	7	6	3	5	2	9	4	8
6	4	5	2	1	9	8	3	7
2	1	3	6	8	7	5	9	4
8	9	7	5	3	4	1	6	2
7	8	1	4	9	6	2	5	3
3	6	4	8	2	5	7	1	9
9	5	2	1	7	3	4	8	6

Argëtim filozofik

- "Mos shkatërro atë që ke, duke dashur me epush atë që nuk ke. Mbjaj mend se ajo që tani ke, dikur ishte gjëja e parë e atyre që dëshiroje të kishë".
Epikuri

- "Miku i vërtetë është ai i cili duke të dhënë dorën, të prek zemrën".
Gabriel Garcia Marquez

- "Mos ki frikë nëse përparon ngadalë. Kij frikë nëse do të qëndrosh në vend dhe nuk do të përparosh".
Konfuci

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	17	14	4	6	7	3	10	6	16	9	6
11	18	13		8	5	7	2	1		6	1
3	4		7		1				14	3	1
1		8	1	7	10	1	2	3	14	9	6
	8	1	2	14	3	10	3	11	6		7
10	1	7	3	1	16	1	4	3	16	6	12
3	7	3	14		13			7	1	14	1
17	1	14	9	1		P	S	O	P	T	
	12	6	6	4		6		9	5	7	9
18		15	9		16	9	10		7	6	1
8	1	9		18	15	6		14	6	12	7
5	12	6		17	18	7	3	10		3	1

K U L T M A P L A B
O R E K A S T I L E R
R U L A K T O R I A L E
B K L E O P A T R A
I E K I T R E T E S
L A M E K E R M A T
T E R M A T A R I C E
O T M O S C I R M A
B R E D H I A I R K
I L E I N E P H I L
A N A L I T I K E A M I
S E T E S K I C A T O

Thënie të mençura

- Kush është i zgjuar? Ai që mëson nga të gjithë.
- Kush është i fuqishëm? Ai që zotëron pasionet.
- Të mos dish disa gjëra të caktuara, është një pjesë e rëndësishme e zgjuarsisë. (Hugo Grotius)
- Jemi ajo që mendojmë. Ajo që jemi është produkt i mendjes sonë. Çdo fjalë ose vepër që lind nga ndonjë mendim i turbullt, ndiqet nga vuajtje, ashtu si rota e karrocës që ndjek këmbët e demit.
- Mos mbivlerëso atë që ke marrë dhe mos lakmo tjetër. Ai që lakmon tjetër nuk do arrijë paqen e mendjes.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

